



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave  
në “Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike”**

**I**

**Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Vjollca Durro

Dr. Nevila Heta

Tetor 2021

**Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Mjekësisë: Departamenti i Shkencave Biomjeksore Departamenti i Shkencave Mjekësore (Tiranë dhe Elbasan) Departamenti i Shkencave Kirurgjikale
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 340, datë 19.08.2013 (VKA Nr. 526, datë 18.07.2013)
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 220 date 14.11.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMAS Nr. 334, datë 16.09.2015
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Italisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Po
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Laurea Magistrale in Scienze Infermieristiche e Ostetriche
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7(Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE/14 PAK
18	Numri i studentëve:	30 studentë (nr. për një cikël të plotë studimi)

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit, Master Shkencor në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike" zhvillohet në Fakultetin e Mjekësisë dhe Kirurgjisë pranë Universitetit Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë", Tiranë. Ky program studimi është hapur në vitin 2013, me Urdhrin e Ministrit nr. 340 datë 19.08.2013 të MASH dhe kryhet në bashkëpunim me Universitetin "Tor Vergata" në Romë. Ky program studimi është hartuar dhe realizohet në bazë të marërveshjes së bashkëpunimit dypalësh midis Universitetit Katolik në Tiranë dhe Universitetit "Tor Vergata" në Romë bazuar në Legjislacionin Shqiptar dhe Italian, nga profesorë italianë dhe shqiptarë.

Në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë diplomën Master i Shkencave në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike" në Republikën e Shqipërisë dhe *Dottore Magistrate* në Republikën Italiane, e cila lëshohet si diplomë e përbashkët e Universitetit Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë" dhe Universitetit "Tor Vergata" Romë, Itali. Fakulteti i Mjekësisë ka filluar aktivitetin e tij akademik në vitin 2004 si pjesë e Universitetit Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë" pranë të krijuar me VKM nr. 567 datë 27.08.2004, me programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi" dhe "Infermieristike" dhe në vitin 2013 u hap program i studimit të nivelit të dytë, Master i Shkencave në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike". Programi ofrohet me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 2 vite akademike.

Programi i studimit Master i Shkencave mund të frekuentohet nga student që zotërojnë një diplomë "Bachelor" në Infermieristikë dhe profesione të tjera në fushën e mjekësisë, të fituar në Universitetet e Akredituara të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetet e Bashkimit Evropian. Ky program studimi është akredituar sipas legjislacionit Shqiptar dhe Italian, në të dy shtetet. Në Shqipëri është akredituar në vitin 2015 me Vendimin nr. 334, datë 27.07.2015 të MASH dhe Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 74, datë 27.07.2015, me vlefshmëri maksimale prej (gjjashtë) vitesh akademike. Bordi i Akreditimit nuk ka lënë rekomandime për këtë program nga studimi. Në Itali nga institucioni partner është akredituar nga Ministria e Arsimit, Universiteti i Kërkimit, MIUR) me Vendimin nr. Prot 0000435, datë 13.06.2014.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Raporti i vlerësimit të jashtëm është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit Master Shkencor në "Infermieri", i ofruar nga UKZKM. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë të studimit Master Shkencor në "Infermieri", pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore, finaciare, infrastruktura, logjistika për realizimin eporgramit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Vjollca Durro dhe Dr. Nevila Heta Alliu Koordinaore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Arjana Alija.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj fazë janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UKZKM e zhvilluar në datat 21 dhe 22 Qershor 2021. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UKZKM.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike"

Bazuar në pikën 4, neni 80 i ligjit të arsimit të arsimit të lartë për programet e përbashkëta të studimit theksohet:

### **Neni 80**

#### **Programet e përbashkëta të studimit**



1. Programet e përbashkëta të studimit realizohen nga një institucion i arsimit të lartë ose njësi kryesore të tij, në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose jopublike brenda ose jashtë vendit.
2. Procesi i realizimit të programeve të përbashkëta mund të kryhet në një ose në institucionet pjesëmarrëse, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit.
3. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë e përbashkët ose diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë nga institucionet pjesëmarrëse.
4. Në kushtet e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë mund të zbatohen standarde të ndryshme nga ato shtetërore.
5. Hapja e programeve të përbashkëta të studimit bëhet me miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.



## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË


Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike” me Vendimin nr. 334, datë 27.07.2015 të MASH dhe Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 74, datë 27.07.2015 ka perfituar akreditimin me vlefshmeri të plotë 6 vite akademike pa asnjë rekomandim nga Këshilli i Akreditimit.

*Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.09.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 135/43 Prot, datë 27.09.2021. Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 160/15 Prot, datë 01.10.2021, “Kthim përgjigje mbi draft-raportin e vlerësimit të jashtëm”, ku konfirmon dakortësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.*



**OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike"**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve", në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron program studimi "Master i shkencave"/"Master i arteve" që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti Katolik Zonja e Këshillit të Mirë (UKZKM) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM nr. 567 datë 27.08.2004 të qeverisë shqiptare dhe me iniciativën e Fondacionit me të njëjtin emër ZKM. Ky institucion në programet e studimit që realizon në fushën e mjekësisë, lëshon diplomë të përbashkët midis UZKM në Tiranë dhe Universitetit "Tor Vegata" në Romë dhe funksionon në bazë të marveshjes dypalëshë. Institucioni është akredituar në vitin 2009, riakredituar në 2017 nr. 112, datë 15.12.2017 për një afat 6 vjeçar deri në vitin 2023. Dhe institucioni i tij partner në Itali është akredituar sipas legjislacionit Italian. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare të dy vëndeve respektive dhe janë në përputhje me profilin e institucionit dhe kanë si qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe formim profesional në nivelin e vëndeve të BE-se për Shqipërinë dhe vëndet e rajonit. <b>[takimi me dekanin dhe shefat e departamenteve për shkaktë pandemisë u zhvilluan online, dekretet e akreditimit në Itali].</b></p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UZKM synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UZKM në mbështetje të zhvillimit social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë shiptare si dhe përparimit të arsimit të lartë dhe kërkimor shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal. <b>Veprimtaria e UZKM është fokusuar në Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Politike, Fakulteti i Farmacisë dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Keto fakultete kanë hapur programet në të tre ciklet e studimit në përputhje me fushën e tyre [statusi dhe rregullorja e ZKM].</b></p> <p>Gjatë takimit me dekanin dhe shefat e departamenteve e FM dhe kordinatoren e programit të studimit, programet e studimit të ofruara nga ZKM dhe FM bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat e tregut të punës në shqipëri dhe Itali për këto profesione nëpërmjet kontakteve dhe informacionet të mara nga drejtues të institucione shëndetësore publike dhe jo publike në strukturat spotalore dhe shërbimit parësorë, me drejtues të urdhrave profesionistë përkatës. Në bazë të dokumnetacionit të vënë në dispozicion GVJ konstaton se pothuajse të gjithë të diplomuarit janë të punësuar. Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion.</p> <p>Referuar strategjisë së zhvillimit të ZKM dhe planin e zhvillimit</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor	




	<p>institucional, programi i studimit është në të njëjtin linjë me zhvillimet social-ekonomike dhe arsimor të vendit, shërbimit shëndetësor dhe politikave lokale apo rajonale. <b>[strategjia UET &amp; programit të studimit, dokumenti i studimit të tregut të punës].</b></p> <p>Prorami i studimit Msc në “Shkenca infermieristike dhe obsterike” ju shërben studentëve për thellimin e dijeve dhe përfitim të kompetencave profesionale në fushën e manxhimit dhe drejtimit të fushave specifike të kujdesit shëndetësor, të thellojnë njohuritë në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor në fushën përkatëse, metodologjinë e kërkimit shkencor, metodat statistikore etj. Njohuritë e mara në këtë program shërbejnë si bazë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretësi dhe përfshirjen e tyre në aktivitetin mësimdhënës <b>[programit të studimit].</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	UZKM ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2027 ku përfshihen edhe plani i zhvillimit të Fakultetit të Mjekësisë në të cilën janë përcaktuar qartë drejtimet strategjike të zhvillimit të programeve, fushat e studimit dhe kërkimit shkencor të cilat të janë në përputhje me fushën e veprimtarisë dhe statusin e UZKM. Fakulteti i mjekësisë ku realizohet ky program studimi funksion në bazë të Rregullores së Fakultetit të mjekësisë të miratuar nga rektori i UZKMs dhe rregulloreve të programeve të studimit që zhvillohen pranë fakultetit si dhe rregulloreve në bazë të të cilave realizohet procesi akademik dhe kërkimomor shkencor. <b>[rregullorja e FM, programit të studimit, NJSBC, sekretarisë, burimeve njerëzore, rregullorja e provimit etj].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<i>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se aktet rregullatore janë sipas formatit zyrtarë.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	Programi i studimit Msc në “shkenca infermieristike dhe obsetrikë”, zhvillohen në formë të përbashkët midis universitetit katolik ZKM dhe universitetit “Tor vergata” në Romë. Rregullorja dhe plani mësimor i programit në FM në UZKM në Tiranë, pasqyrojnë programin dhe planin mësimor në fuqi që zhvillohet në Fakultetin e
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit	



mjekësisë dhe kirurgisë në universitetin “Tor vergata” në Romë. Mësimdhënia për çdo lëndë të programit në FM në Tiranë realizohet nga pedagogë titullarë të këtyre lëndëve në FM dhe kirurgjisë në Universitetin “Tor vergata” në Romë si dhe pedagogë shqiptarë të miratuar nga rektorët e UZKM dhe Universiteti “Tor Vergata” si dhe komiteti teknik i përbashkët në fillim të çdo viti akademik. Gjatë takimit me stafin drejtues u theksua së universiteti ka qëllim të risë numrin e pedagogëve shqiptarë me kohë të plotë deri në aritjen e një përbërje 50%. [takimi me dekanin dhe shefat e departamenteve, kurikula dhe plani mësimor i universitetit Tor vergata Romë dhe UKZKM].

Hapja, emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe bazohen në dekretet e miratuar nga Ministria e arsimit dhe universitetit, Itali nr 2634, datë 21.11. 2014 ku përcaktohen titulli studimit mastër shkencor në:

- shkenca infermieristike dhe obsetrikë
- shkenca rehabilituese të profesioneve sanitare
- shkenca teknikesi laborator, diagnostika, mjeksi transfuzive.
- shkenca parandaluese në shëndet publik

Në përfundim të studimit lëshohen diplomë e përbashkët e UZKM dhe Universitetit “Tor Vergata” Romë.

**[takimi drejtuesit, shefi departamentit, dekreti rektorit universitetit “Tor Vergata” nr 2634, datë 21.11. 2014]**

Programi i studimit zhvillohet Bazuar në Statusin e UZKM-së, rregulloret e FM dhe programit të studimit të cilat janë në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit, planin strategjik të zhvillimit të UZKM-së dhe kërkimit shkencor që përputhen me interesat kombëtar dhe trendeve e zhvillimit global. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe planifikimi për hapjen e programe të studimi në fusha të tjera të mjekësisë si programi i specializimit afat gjatë në kirurgjinë plastike, master ekzekutiv në mjeksi ligjore, kardiologji interveniste, ekokardiologji klinike etj, program doktorature etj [strategjia e zhvillimit të institucionit].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi I.3**

**Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse objektivat, mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij. Bazuar në këto objektiva, programi i ciklit të dytë Msc “Në shkencat infermieristike dhe obstetrike” synon të përgatisë profesionistë të specializuar sipas standarteve europiane, të aftë profesionalisht për të punuar në sektorin publik dhe jo publik të shëndetësisë, të rris mësim nxënien në disiplinat infermieristike dhe obstetrike, të zhvillojnë aftësitë profesionale dhe kompetencat lidhur me evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve shëndetësore në fushat të veçanta, drejtimin, komunikimin, metodologjinë e kërkimit shkencor për ti aftësuar studentët në kërkimin të avancuar të pavarur shkencorë, për zhvillim karriere, si dhe të krijoj bazën për vazhdimin e studimeve të doktoraturës <b>[rregullorja e programit, plani mësimor dhe kurikula]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ identifikoi se institucioni akademik dhe drejtuesit, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në mënyra të ndryshme si nëpërmjet studimit të tregut të punës, takimeve të zhvilluara më petagogë, drejtuesit e urdhërit të infermierit apo drejtues të institucioneve shëndetësore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Institucioni ka databaze lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi ku rezulton se të gjithë të diplomuarit janë të punësuar në profesion. GVJ konstaton sidomos rritje të punësimit të diplomuarve në këtë program gjatë periudhës së pandemisë në strukturat shëndetësore publik dhe jo publike kombëtare dhe ndërkombëtare. [dokumneti nr.16. Analiza e tregut të punës, takimi me zyrën e këshillimit të karrierës].</p>
	<p>Programi i studimit Msc “Në shkencat infermieristike dhe obstetrike” është organizuar në përputhje me legjislacionin Italian dhe përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite ECTS. Programi Msc “Në shkencat infermieristike dhe obstetrike” është me kohë të plotë studimi me zgjatje dy vite akademike, të organizuar në 4 semestër dhe ngarkesë vjetore për dy vite akademike 120ETC[plani mësimor].</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Hartimi dhe strukturimi programit të studimit është i njëjtë me universitetin partner “Universiteti i mjekësisë dhe kirurgjisë Tor Vergata” në Romë, bazuar në legjislacionin e dy vendeve respektive dhe atë të BE për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara. Titulli i diplomës është i përbashkët midis dy univesiteve UZKM në Tiranë dhe Tor vergata në Romë. Kjo u mundëson studentëve njohjen e diplomës në vendet e BE si dhe mundësi punësimi të tyre pas diplomimit në institucione shëndetësore ndërkombëtare.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Në kurikulën e programit të bie në sy shpërndarja e krediteve për të gjitha lëndët sipas legjislacionit dhe lidhje midis lëndëve karakterizuese dhe atyre integruese.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për nivelin e ciklit të dytë të studimeve. Ky program ofron njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike për aftësimin dhe zhvillimin e kompetencës profesionale të studentëve në fushën e infermieristikës dhe obsetrikës si dhe metodat e kërkimit shkencor <b>[takimi me stafin drejtues, statusi UZKM, Plani mësimor dhe rregullorja e programit].</b></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale. Ndërthuarja e njohurive teorike me kryerjen e praktikës profesionale i mundëson studentëve formimin profesional për përshtatjen e tyre në tregun e punës. Praktika profesionale ju mundëson studentëve njohjen nga afër me detyrat që do të ketë infermieri i cili do të punësohet në pozicione pune në fushën akademike/mësimdhënie, në fushën organizative në institucione shëndetësore spitalore apo ambulatorë publike dhe jo publike apo përfshirjen e tyre në kërkimin shkencor.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Bazuar në objektivat që ka programi dhe në planin mësimor, mësimdhënia zhvillohet në gjuhën Italiane. Kjo reflektohet në pranimin në këtë program studimi të studentëve nga shqipëria, rajoni, Italia. Në takimet në UZKM dhe RVB theksohet se UZKM ka një sërë marrëveshje me institucionet arsimore dhe shëndetësore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat janë në dispozicion të GVJ[faqja web e ascal-it].</p> <p>Institucioni ka një system të mirëorganizuar për ruatjen dhe arkivimin e gjithë dokumentacionin lidhur me organizimin dhe realizimin e programit mësimor, të dhënat e studentëve, stafit akademik, programin dhe planin mësimor në dy gjuhë shqip dhe Italisht[visita në institucion].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht

#### Standardi I.4

**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni i Arsimit të Lartë UZKM ka një eksperiencë të gjatë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Universiteti Katolik ZKM (UKZKM) në Tiranë është licencuar në vitin 2004 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 567 datë 27.08.2004 të qeverisë shqiptare, akredituar në vitin 2009 dhe riakredituar në vitin 2017 me vendim të BA nr.112, datë 15.12.2017 me kohëzgjatje normale 6 vite akademike. UKZKM ushtron aktivitetin akademik dhe lëshon diplomë të përbashkët në programin e studimit që realizon me Universitetet italiane sipas marrëveshjes dypalëshe midis tyre. Aktiviteti akademik i UKZKM filloi me <i>Fakultetin e Mjekësisë</i> (me programin e studimit Bachelor në "<i>Fizioterapi</i>" dhe "<i>Infermieristike</i>") dhe <i>Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Politike</i>. Në vitin 2005 filloi <i>Fakulteti i Farmacisë</i> dhe në 2015 u krijua <i>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara</i>. Në vitin 2013, Fakulteti i Mjekësisë hap me Urdhërin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 340 datë 19.08.2013 programin e ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në "<i>Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike</i>" i cili kryhet në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë dhe Kirurgjisë së Universitetit "Tor Vergata" në Romë. Në UKZKM programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë janë programe të përbashkëta me Universitete Italiane si Universitetit i Milano-s, Tor Vergata në Romë, Universiteti i Barit, të cilat kanë kapacitetet e nevojshme dhe një eksperiencë të gjatë në aktivitetin akademik dhe kërkimor shkencor në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë.</p> <p>GVJ e konsideron praktikë të mirë infrastrukturën mësimore që disponon institucioni UKZKM dhe Fakulteti i mjekësisë ku zhvillohet ky program studimi. Për zhvillimin e programeve mësimore UKZKM ka në dispozicion të studentëve sallën informatike multimodale e paisur me laptopë për studentët dhe pedagogët, videoprojektorë. Qendra e simulimit që përdoret për praktika, ushtrime apo raste klinike për studentë që ndjekin programet e studimit në lëndët mjekësore në të tre nivelet. Gjithashtu fakulteti i mjekësisë ka në dispozicion katër laboratorë mësimorë mjekësorë të cilat zotërojnë pajisjet e duhura laboratorike</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	

që ndihmojnë në praktikimin e njohurive të marra nga studentët si laborator i anatomisë makroskopike, laborator i mikroskopisë, laborator i infermierisë dhe laborator i odontoiatrisë si dhe sallën e studimit autonom me 20 poste pune për studentët.

Tashme institucioni ka krijuar profilin e vetë në mënyrën e organizimit, funksionimit, kapaciteteve infrastrukturore, burimeve njerëzore dhe burimeve financiare që disponon të cilat mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit [vizita e ambienteve].

Programi i studimit Msc në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike" zhvillohet nga Fakulteti i Mjekësisë dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. FM përbëhet nga tre departamente si departamenti i shkencave mjekësore, departamenti i shkencave biomjekësore dhe departamenti i shkencave kirurgjikale dhe ofron programe studimi me diplomë të përbashkët me universitetin e mjekësisë dhe kirurgjisë "Tor Vergata" në Romë si vijon:

- a) Bachelor në "Fizioterapi"
- b) Bachelor në "Infermieristike"
- c) Mastër i shkencave me cikël të intergruar në mjeksi dhe kirurgji"
- d) Mastër i shkencave me cikël të intergruar në odontoiatri dhe proteza dentare"
- e) Master i shkencave në "shkenca rehabilituese të profesioneve sanitare".
- f) Master i shkencave në Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike"
- g) Masëtr-i nivelit të dytë në ortodonsi.
- h) Mastër i nivelit të dytë në implantologji dhe proteza dentare
- i) Mastër i nivelit të parë për manaxhim dhe funksionet e kordinimit

Zhvillimi i procesit mësimor në Fakultetin e Mjekësisë, si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi realizohet nga pedagogë efektive (PAE) dhe pedagogë me kontratë (PAK) Italianë dhe Shqiptarë të cilët miratohen çdo vit akademik nga rektorët e të dy universiteve.

Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në FM 2 staf ndihmës administrativë dhe 25 pedagogë prej të cilëve në :

- Departamenti i shkencave biomjekësore janë angazhur në mësimdhënie 9 (nëntë) pedagogë prej të cilëve 4 (katër) janë PAE dhe 5 (pesë) PAK. Nga PAE 4 janë me gradën doktor shkencash. Nga PAK 1 (një) është prof as, 2 (dy) janë

doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc(SPA).

- *Departamenti i shkencave mjeksësore* janë angazhuar në mësimdhënie 10(dhjetë) pedagogë prej të cilëve 6(gjashtë) janë PAE dhe 4(katër) PAK. Nga PAE 2(dy) janë të kategorisë profesor, 2(dy) janë me gradën doktor shkencash dhe 2(dy) janë Msc/SPA. Nga PAK 1(një) është prof as, 1(një) është doktorë shkencash dhe 2(dy) janë Msc(SPA).
- *Departamenti i shkencave kirurgjikale* janë angazhuar në mësimdhënie 6(gjashtë) pedagogë prej të cilëve 1(një) është PAE dhe 5(pesë) janë PAK. Nga PAE 1(një) është me gradën doktor shkencash. Nga PAK 5(pesë) janë doktorë shkencash.

Profili i programit të studimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij përputhet me atë të njësisë kryesore **[rregullorja e FNM, dekreti i rektorit për stafin akademik, rregullorja e programit të studimit, tabelat përmbledhëse 1,2,3]**

Programi i studimit mastër shkencor në infermieristikë dhe obstetrikë, ofrohet nga Departamentet e FM, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit European të transferimit të krediteve ETC/CFU(Itali) në përputhje të plotë me statusin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptarë dhe atë Italian. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën italiane dhe përfshin aktivitete mësimore në fushën e menaxhim administrimit, organizmit, metodat e kërkimit shkencor, përpunimit statistikor, shkencat infermieristike në përputhje me interesat dhe nevojat kombëtare të dy vëndeve sepse ky program studimi bazohet në programe mësimore të përbashkëta dhe lëshimin e diplomave të përbashkëta bazuar në marrëveshjen midis “Universitetit të mjekësisë dhe kirurgjisë Tor Vergata” në Romë dhe UKZKM në Tiranë. Për këtë qëllim përgatitet dhe kurikula e përbashkët për arritjen e këtij obkektivit[kurikula e programit].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>UKZKM është një institucion jo publik që funksion në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brënda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës. Aktet rregullatore përcaktojnë detyrat, përgjegjësitë e stafit sipas pozicionit dhe funksioneve që kryejnë në strukturat e universitetit, fakultetit apo programit të studimit ku ata janë të angazhuar. Anëtarët e stafit akademik janë të angazhuar në pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione “ad hoc” të ngritura për tematika të ndryshme. Në mënyre periodike strukturat përkatëse si njësi bazë, NJSBC, sekretariatë mësimore, këshillimi i karrierës, programet e studimit kryejnë analizën e aktivitetit të tyre, nxjerrin përfundimet dhe përcaktojnë masat që duhen të meren në zgjidhjen e problematikave të ndryshme apo përmirësimet e nevojshme. Në komunikimin e brëndshëm midis stafit të institucionit një rol të rëndësishëm sistemi i komunikimit elektronik nëpërmjet se cilit realizohet shkëmbimi dhe përditësimi i informacionit, ndarja e punës etj. Ky sistem është vecanërisht i rëndësishëm komunikimi jo vetëm me stafin e UKZKM por dhe universitetet partnere në Itali [takimi me stafin akademik, koordinatoren e programit të studimit, burimet njerëzore, njësin ekërkim shkencor dhe projekteve, NJSBC].</p> <p>UKZKM është një institucion i arsimit të lartë jo publik që ka disa programe studimi në fushën e mjekësisë ku bën pjesë dhe ky program studimi me një numër të vogël studentësh. Për vitet akademike nga 2015-2020 në këtë program studimi janë diplomuar 34 studentë të cilët janë punësuar të gjithë në struktura shëndetësore publike dhe private në shqipëri dhe jashtë vëndit. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master shkencor në shkencor në infermieristikë dhe obsetrikë, institucioni i UKZKM ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet shëndetësore publike e private si dhe urdhërin e profesionistëve [RVB, takimi me stafin drejtues, marrëveshjet],</p> <p>Një vënd të rëndësishëm në planin mësimor të programit Master shkencor në infermieristikë dhe obsetrikë, zë praktika profesionale. Për realizimin e saj UKZKM kanë shkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme shëndetësore publike e private si Spitali Universitarë i Traumës, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, spitali Rajonal i Durrësit dhe Urdhërin e Infermierit. [RVB, takimi me stafin drejtues, marrëveshjet].</p> <p>UKZKM zotëron një praktikë të mirë në organizimin e programeve të kryerjes e praktikës profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Praktika kryhet sipas sylabusit të miratuar për</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vëndit, aktorët e biznesit vëndës dhe/ose të huaj.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	

praktikën profesionale. Në vitin e parë të praktikës studenti kryhen rishikim të literaturës, ndërsa në vitin e dytë kryhen mbledhjene të dhënave dhe metodologjinë e studimit, metodat e përpunimit statistikor të të dhënave. Praktika mbyllet me provimin e praktikës i cili është teorik dhe praktikë.

UZKM përpiqet që nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të ndihmojë studentët për zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale si pjesëmarrja në konferenca apo seminare, botime në revistat shkencore brënda dhe jashtë vëndit. Nëpërmjet, Alumni, institucioni përpiqet të mbajë kontakte me studentët e diplomuar **[takimi me stafin drejtues, akademik]**.

Institucioni ka një databaza lidhur me institucionet ku studentët kryejnë praktikën profesionale. Praktika mbikqyret nga një kordinator i caktuar, kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Realizimi i praktikës dhe vlerësimi kryhet sipas sylabusit dhe regullores përkatëse të FM. **[dokumenti praktikës, takimi me stafin akademik]**.


Institucioni UZKM siguron kryerjen e projekteve kërkimore shkencore në bashkëpunim me universitetin partner të mjekësisë dhe kirurgjisë “Tor Vergata” në Romë i cili përfshin pjesëmarrjen në seminare, publikimet të artikujve në revista shkencore si dhe realizimin e temave të diplomave eksperimentale për studentët e këtij program. Universiteti organizon thirrjen për projekte me fonde të brëndshme të UKZKM dhe thirrjet e jashtme me fonde nga organizma të ndryshme ndërkomëbtare. Projekte me fonde të UKZKM kanë filluar në vitin 2019 dhe janë fituar 23 projekte ku një projekt “selfacare në sëmundjet kronike është fituar nga program i studimit Master në Shkencat Infermiristike dhe Obsetrike. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19 realizimi i këtyre projekteve është zgjatur në kohë. Projekte me fonde të jashtme janë projekti “Capacity building” dhe projekti me të njëjtin emër Capacity building me Universitetin Polis, projekti me NATO-n për ndërtimin e laboratorit të virologjisë.

Një vënd të rëndësishëm në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet partnerë zë lëvizja e studentëve në këto universitete. Lëndët apo modulet që studenti do të ndjek në Unversitetin pritës verifikohen nga struktura përgjegjëse e



	<p>programit të studimit dhe bëhet vlerësimi krediteve që student do të marr në Institucion pritës. Studenti i nënshtrohet provimeve në lëndët e zhvillura si studentët vendas. <i>GVJ evidentoi se nuk ka mobilitet në universitetet partnere, dhe gjithashtu as mobilitet të studentëve. Theksojmë se studentët të cilët ndjekin këtë program studimi janë Shqiptarë dhe Italianë.</i></p> <p>Gjatë takimit me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se interes për mobilitetet drejt Universitetit Partner Tor VERGATA me të cilin ofrohet kjo diplomë e dyfishtë, tregojnë jo vetëm studentët shqiptarë drejt Italisë por edhe studentët Italianë për të ardhur në shqipëri për të shkëmbyer eksperiencë jo vetëm në programin mësimor por dhe për t'u njohur me mënyrën e jetesës, kulturën dhe traditat shqiptare.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit në mënyrë periodike harton raportin mbi realizimin e programit mësimor, opinionin e studentëve lidhur me logjistikën në funksion të programit, aktivitetet të kryera gjatë vitit akademik në funksion të programit të studimit, Raportin për përfitimet nga marrëveshjet”. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperiencë, kërkimit shkencor, mobilitetit etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë [takimi me kordinatorin e programit, rregullorja e FM].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

<b>Standardi I.6</b> <b>Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I.</b> Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	Kërkimi shkencor përbën një nga veprimtaritë kryesore të UKZKM të reflektuar në statusin e UZKM dhe rregulloren e FM dhe programit të studimit. Universiteti mbështet dhe promovon kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve. Me vendim senatit akademik dhe këshillit të administrimit është ngritur komiteti shkencor dhe bordi editorial i revistes shkencore me dekretin nr. 407 datë 25.09.2019 të rektorit të universitetit. Numri




	<p>iparëi revistësi kushtohet fakultetit të shkencave ekonomike, politike dhe sociale, numri i dytë fakultetit të shkencave të aplikuara dhe numri i tretë fakultetit të mjekësisë dhe farmacisë. Revista shkencore EVOLUTION gjendet në dy formate elektronik (ne ëeb-in e UKZKM) dhe formatin e printuar.</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	UKZKM ka një strukturë të vecantë nën varësinë e rektorit të UKZKM për monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit kërkimor shkencor që është zyra e projekteve dhe mobilitetit të studentëve në kuadër të programit Erasmus. Kjo zyrë informon stafin akademik dhe studentët për mundësitë e lëvizjes dhe shkëmbim eksperience, thirrjet për projekte të ndryshme me fonde të brendshme apo të jashtëme. Kjo zyrë bën gjithashtu monitorimin dhe vlerësimin e realizimit të projekteve pasi fitohen <b>[takim me njësinë e projekteve]</b> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Përpromovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe shkëmbimin ekulturave midis vendeve është dhe botimi buletinit Pontes. Gjithshtu buletini Pontes shërben si burim informacioni për universitetet shqiptare, kulturën dhe traditat tona për studentët italianë duke ju mundësuar atyre të jetojnë dhe studiojnë në Shqipëri. Institucioni mbështet dhe përkrah kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e studimeve individuale në fushën e kërkimit [dokumenti nr 28 pontes].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## I. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit” Master shkencornë infermieristikë dhe obsetrikë”, është hapur në vitin 2013, me Urdhrin e Ministrit nr. 340 datë 19.08.2013 të MASH dhe kryhet ne bashkëpunim me Universitetin "Tor Vergata" në Romë, në bazë të marveshjes së bashkëpunimit dypalëshë bazuar në Legjislacionin Shqiptar dhe Italian. Në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë diplomën Master i Shkencave në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike" në Republikën e Shqipërisë dhe <i>Dottore Magistrate</i> në Republikën Italiane, e cila lëshohet si diplomë e përbashkët e Universitetit Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë" dhe Universitetit "Tor Vergata" Romë, Itali. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë dhe i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), dhe organizohet në 120 (ECTS) dhe kohëzgjatje 2 vite akademik, të ndarë në katër semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe atij Italian.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” , dekretit 2 prill 2001, nr 128 të “Ministrit të Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit Shkencor.” Sipas Nenit 7 të dekretit të Ministrit datë 19.02.2009 [rregullorja e programit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit “Master shkencornë infermieri dhe obsetrikë”, përmban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës dhe obstetrikës. Ky informacion i shërben studentit për marjen e njohurive, në fushat specifike të kërkimit shkencor, metodologjisë së kërkimit shkencor; të thellojnë njohuritë rreth modelve, mjeteve të vlerësimit të kuptuarit dhe efikasitetit didaktik; mbi parimet organizmin dhe administrimin në strukturat shëndetësore si dhe përfitim të aftësive profesionale dhe kompetencave për manaxhimin e pacientit me etike dhe kujdesje profesionale në zgjidhjen e situatave komplekse; për përfitim të njohurive dhe aftësive teorike në fushën e trajnimit dhe mësimdhënies në shëndetësi [programi studimit].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit në përmbatjen e tij (syllabuset) përfshin</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	

**Kriteri 7.** Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj

lëndë specifike që lidhen me kërkimin shkencor, organizimin dhe administrimin e strukturave shëndetësore, si drejtimin e grupet e punës, organizimin dhe implementimin e planeve për zhvillimit profesional të stafit që lidhen me edukimin në vazhdim, identifikimin e problemeve të kërkimit shkencor dhe klinik, Njohuritë e fituar i shërbejnë studentit për përfitim e aftësive dhe kompetencave për të kryer në mënyrë të pavarur një kërkim empirik në fushën e infermieristikës dhe obstetrikës, për tu përballur dhe zgjidhur problemetika të lidhura me organizimin e strukturave shëndetësore, për tu përshtatur me kërkesat e tregut të punës dhe si bazë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme të doktoratës. **[rregullorja e programit, plani mësimor]**

Njohuritë e fituara në këtë program studimi, i krijon mundësi studentit në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave në fushën administrimit, organizmit, në fushën akademike dhe kërkimit shkencor.

Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, ky program studimi i shërben kualifikimit të mëtejshëm të tyre për një pozicion më të lartë pune/pozicion drejtues, fitimin e kapaciteve të nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike, si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë dhe obstetrikës si dhe për të marë drejtim akademik duke angazhuar në mësimdhënie **[rregullorja e programi, takimi me studentët]**

Programi i studimit Msc “Master shkencor në infermieri dhe obstetrikë” është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS (ose 1500 orë mësimorë/vit akademi) nga të cilat 30 ECTS(750 orë mësimore) përkasin praktikës profesionale dhe 5 ECTS punimit të diplomës **[plani mësimor]**.

Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin. Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta. **[Rregullorja e programit të studimit]**

Në semestrin e dytë, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve/qëndrave shëndetësore publike dhe jo publike me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi. **[marrëveshjet, analiza e marrëveshjeve]**

Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të ndarë në dy semestra, 14 jave semestri gjatë një viti akademik. **[Rregullorja e funksionimit të programit, kurikula e programit, plani mësimor,**

**ngarkesa mësimore e pedagogëve].**

Pedagogët e programit të studimit dhe ngarkesa vjetore( e përlogaritur në ETC dhe orë mësimore) miratohet në fillim tëçdo viti akademik nga rektori i universiteti “Tor Vergta” në Romë me dekretin 23 tetor 2020, nr 414. **[plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e petagogëve të përfshirë në program, dekreti rektorit ].**

Sylabuset janë të organizuar sipas kriterëve të përcaktuar në VKM nr.41, datë24.01.2018.Bazuar në ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por nga dokumnetacioni i vënë në dispozicionGVJ konstatoi se **titullarët e lëndës nuk janë të gjithë të kategorisë Profesor. (Cv e stafit, plani mësimor)**

Pjesë e programit të studimit është dhe praktika profesionale e cila është 15 ETC/375 orë mësimore/vit akadkemik dhe kryhen sipas sylabusit përkatës dhe programit kalendarik në semestrin e dytë të vitit akademik **(referuar dokumentit të planit mësimor.)**

Praktikat profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike më të cilat UKZKM ka nënshkruar kontrata bashkëpunimi si Qendra Spitalore Uniiversitare Nënë Tereza, Spitali Universitarë i traumës, Spitalin Hygea, Spitali Rajonal Durrës, qendra spitalore Elbasan dhe urdhrin e Infermierit të Shqipërisë. Praktika profesionale mbikëqyret nga një udhëheqës i caktuar nga fakulteti dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës, institucioni ku kryhet praktika. **[sylabusi i praktikës profesionale, takimi me kordinatorin e programit dhe stafin akademik ].**

*Për sa më sipër GVJ rekomandon titullarët e lëndës të jenë të gjithë të kategorisë profesor.*

Programi master shkencor është i organizuar sipas VKM nr 41 datë24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë ku lëndët formuese realizohen në ETCS dhe grupohen në:

- A. Lëndë bazë
- B. Lëndë karakterizuese,
- C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese
- D. Lëndë plotësuese:
- E. Detyrime përmbyllës

	<p>Diplomimi i studentëve bëhet me temë diplome e cila vlerësohet në programin e studimit me 5ETC. Tema e diplomës udhëhiqet nga një pedagogi stafit akademik. Proçedura që ndiqet për temën e diplomës përcaktohet me rregullore të miratuat nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë. Studenti interesuar paraqet kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore gjashtë muaj përpara provimit të diplomimit. Komisioni didaktik cakton udhëheqësin e studentit dhe temën e diplomës dhe ja paraqet për miratim dekanit të fakultetit. Studenti informohet me shkrim nga sekretaria mësimore për temën e diplomës dhe udhëhesin e saj të miratuar nga dekani. Dy javë përpara miratimit të diplomës student dorëzon në sekretarinë mësimore punimin e diplomës në formë të printuar dhe Cd, miratimin e temës së diplomës nga udhëheqësi i tij si dhe duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet që ka ndaj fakultetit. Mbrotja e temës së diplomës kryhet përpara një komisioni të miratuar nga rejtroi i UKZKM të propozuar nga dekani i fakultetit të mjekësisë. Vlerësimi i punimit bëhet me notë sipas mënyrës të përcaktuar në rregulloren e diplomimit [rregullorja e diplomimit].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>UKZKM është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 “Për Arsimin elartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Legjislacionit italian në këtë fushë si dhe Statutit të UKZKM dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë, degën në Elbasan dhe Itali. Institucioni përbëhet nga organet akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademike (Rektori, Dekanët, Drejtuesit e Njësive bazë); organe administrative që janë Bordi i Administrimit, Administratori i universitetit, Njësive kryesore; Organe kolegjiale që janë Këshilli i Rektoratit, Këshilli i Dekanatit, Këshilli Etikës. [statusi i UKZKM].</p> <p>Gjithashtu UKZKM ka plotësuar standardet institucionale dhe është</p>

	<p>akredituar në vitin 2009 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.112, datë 15.12.2017 për një periudhë 6 vjeçare. Programet e studimit që ofron institucioni janë akredituar dhe janë në proces riakreditimit periodik nga institucionet përgjegjëse.</p> <p>Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditor dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Programi Msc në Programin e studimit Msc “Master shkencor në infermieri dhe obsetrikë” realizohet në Fakultetin e Mjekësisë. FM përbëhet nga tre departamente si departamenti i shkencave mjekësore, departamenti i shkencave biomjekësore dhe departamenti i shkencave kirurgjikale dhe ofron programe studimi me diplomë të përbashkët me universitetin e mjekësisë dhe kirurgjisë “Tor Vergata “në Romë. Afati normal përfundimin e studimeve në këtë program studimi është dy vite akademike. Në gjashtë vitet fundit (që prej akreditimit të parë) në njësine kryesore dhe njësitet bazë të saj për realizimin e programeve të studimit janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencorë apo Msc.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Sipas departamenteve shpërndarja e stafit akademik është :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Departamenti i shkencave mjekësore, ka në përbërje të tij 10(dhjetë) pedagogë prej të cilëve 3 janë të kategorisë Profesor, 3 (tre) janë doktorë shkencas dhe 4 janë Msc/SPA.</li> <li>- Departamenti i shkencave biomjekësore ka në përbërje të tij 9 pedagogë prej të cilëve 1 është Profesor i asociuar, 6 gjashtë janë doktorë shkencash dhe 2 janë Msc/SPA.</li> <li>- Departamenti i shkencave kirurgjikale ka në përbërje të tij 6(gjashtë) pedagogë prej të cilëve 6 gjashtë janë doktorë shkencash.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar në FM dy staf ndihmës administrativë dhe 25 pedagogë prej të cilëve 11(njëmbëdhjetë) janë PAE dhe 14(katërbëdhjetë) janë PAK. Nga PAE 2(dy) janë të kategorisë profesor, 7(shtatë) janë doktorë shkencash, dhe 2 (dy) janë Msc/SPA. Nga PAK 2 (dy) janë profesor të asociuar, 8 (tetë) janë doktorë shkencash, dhe 4 (katër) janë Msc/SPA [tabelat përmbledhëse 1,2,3].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesit në njësine përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit “Master shkencor në infermieri dhe obsetrikë” janë angazhuar personeli akademik dhe administrativ të cilët përmbushin kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit sipas pozicionit të punës që kryejnë. Personeli akademik që është angazhuar në këtë program studimi janë staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradën shkencore apo Msc. Në angazhimin e programit mësimor janë përfshirë pedagogë Italianë dhe shqiptarë ku</p>

pedagogët Italianë përbëjnë pjesën më të madhe stafit akademik(80% e stafit akademik). Në takimin me stafin drejtues të fakultetit u theksua se institucioni ka qëllim të risi numrin e pedagogëve shqiptarë të përfshirë në programin e studimit me objektivin që të kemi një përqindje të barabartë 50 % staf Shqiptarë dhe 50% staf Italian. Stafit akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi në vitet 2015-2021 (pas akreditimit të parë) është si vijon :

- Për vitin akademik **2020-2021** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 2 staf ndihmës administrativë dhe 27 pedagogë prej të cilëve 13(trembëdhjetë) janë PAE dhe 14 (katërbëdhjetë) janë PAK.

Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 9(nëntë) janë doktorë shkencash) dhe 1(një) është SPA.

Nga PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 8(tetë) janë doktorë shkencash) dhe 4(katër ) janë Msc( SPA).

- Për vitin akademik **2019-2020** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 25 pedagogë prej të cilëve 13(trembëdhjetë) janë PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë PAK. Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 8(tetë) janë doktorë shkencash) dhe 2(dy) janë Msc/ SPA.

Nga PAK 1(një) ështëi kategorisë Profesor, 7(shtaë) janë doktorë shkencash) dhe 3(tre ) janë Msc( SPA).

- Për vitin akademik **2018-2019** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 25 pedagogë prej të cilëve 14(katërbëdhjetë) janë PAE dhe 11 (njëmbëdhjetë) janë PAK. Nga PAE 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 11(njëmbëdhjetë) janë doktorë shkencash) dhe 1(një) është Msc/ SPA.

Nga PAK 1(një) ështëi kategorisë Profesor, 6(gjashtë) janë doktorë shkencash) dhe 4(katër ) janë Msc( SPA).

- Për vitin **akademik 2017-2018** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 29 pedagogë prej të cilëve 15(pesëmbëdhjetë) janë PAE dhe 14(katërbëdhjetë)) janë PAK. Nga PAE 4(katër) janë të kategorisë Profesor, 11(njëmbëdhjetë) janë doktorë shkencash).

Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 5(pesë) janë doktorë shkencash) dhe 6(gjashtë) janë Msc( SPA).

- Për vitin **akademik 2016-2017** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 29 pedagogë prej të cilëve 15(pesëmbëdhjetë) janë PAE dhe 14(katërbëdhjetë)) janë PAK. Nga PAE 3(tre) janë të kategorisë Profesor, 12(pesë) janë doktorë shkencash).



Nga PAK 3(tre) janë të kategorisë Profesor, (pesë) janë doktorë shkencash) dhe 6(gjashtë) janë Msc( SPA).

- Për vitin akademik **2015-2016** në realizimin e procesit mësimor janë angazhuar 29 pedagogë prej të cilëve 13(trembëdhjetë) janë PAE dhe 16(gjashtëmbëdhjetë) janë PAK. Nga PAE 2(tre) janë të kategorisë Profesor, 8(pesë) janë doktorë shkencash dhe 3(tre) janë Msc( SPA).

Nga PAK 2(dy) janë të kategorisë Profesor, 5(pesë) janë doktorë shkencash) dhe 9(nëntë) janë Msc( SPA).

Gjatë viteve 2015-2021 në këtë program studimi vihet një numër i qëndrueshëm stafi akademik dhe në raportin PAE/PAK përqindjen më të lartë e përbëjnë PAE i cili realizon 80% të ngarkesës mësimore. Në vite raporti PAE/PAK është si vijon:

Për vitin 2020-2021 raporti PAE/PAK është 35/9

Për vitin 2019-2020 raporti PAE/PAK është 32/7

Për vitin 2018-2019 raporti PAE/PAK është 32/4

Për vitin 2017-2018 raporti PAE/PAK është 33/2

Për vitin 2016-2017 raporti PAE/PAK është 32/1

Për vitin 2015-2016 raporti PAE/PAK është 35/5

PAE kanë realizuar në vite ngarkesës mësimore të programit të studimit si vijon :

- viti 2020-2021 PAE kanë realizuar 83% të ngarkesës mësimore
- viti 2019-2020 PAE kanë realizuar 86% të ngarkesës mësimore
- viti 2018-2019 PAE kanë realizuar 76% të ngarkesës mësimore
- viti 2017-2018 PAE kanë realizuar 96% të ngarkesës mësimore
- viti 2016-2017 PAE kanë realizuar 97 % të ngarkesës mësimore
- viti 2015-2016 PAE kanë realizuar 89% të ngarkesës mësimore

Lidhur me treguesit e moshës pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademik dhe gradë shkencore doktorë i përkasin grup moshës relativisht të re 35-55 vjeç. [tabelat përmbledhëse 1,2,3].

Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe teknik dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë.

Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit ndihmës akademik

	<p>në realizimin e praktikave mësimore, mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditorit dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të GVJ dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.</p> <p>Programi ka një koordinator të emëruar E.GJ, i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e sylabuseve sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek dekani i FM.</p> <p>Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuar në rregulloren e funksionimit të Fakultetit të mjekësisë</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në sistem, gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shtesë pas vizitës në institucion [ <b>dosja e programit</b> ] konstaton se Fakulteti i Mjekësisë ku zhvillohet ky program studimi zotëron dhe disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën, përmbajtjen dhe realizimin e programit të studimit. Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe sylabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Referuar dokumentacioni të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar në lëndë formuese dhe praktikë profesionale. Në program është ruajtur raporti në % i shpërndarjes së veprimtarisë formuese në kategori të veçanta sipas përqindjes së përcaktuar në VKM 41datë 24.1.2018 “ <i>Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë</i> ” dhe legjislacionit Italian si vijon:
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<p><b>A. Lëndë bazë 17.5% (21 ETC)</b></p> <p><b>B. Lëndë karakterizuese 55% (66 ETC)</b></p> <p><b>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese 11.7%(14 ETC)</b></p>
<b>Kriteri 5.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen	

<p>me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p><b>D. Lëndë plotësuese: 11.7% (14ETC)</b> <b>E. Detyrime përmbyllës 4.2% (5ETC)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Msc “Master shkencor në infermieri dhe obsetrikë” është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në dy vite akademik të ndara në 4 semestra në total 120 ETC [plani mësimor, kurrikula e programit të studimit].</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Në njësinë kryesore ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit “Master shkencor në infermieri dhe obsetrikë” gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me programin, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe frekuentimin e programit, lista e pedagogëve që zhvillojnë procesin mësimor të miratuara nga Rektori i Universitetit, rregulloren e funksionimit të programit, syllabuset etj. Programi mësimor prej 120 ETC për dy vite akademike është i organizuar në / 1500 orë mësimore/vit akademik ku 375 orë janë të praktikës profesionale dhe 765 orë mësimore studim individual dhe 360 orë mësimore në auditor [programi studimit, plani mësimor].</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion në sekretarinë mësimore konstaton se institucioni ka një informacion të plotë për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programet e studimit. Këto procedura realizohet sipas rregulloreve të UKZKM të miratuara nga rektori [regullorja e FM, regullorja e transferimeve, regullorja e programit]</p> <p>Në njësinë kryesore ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit masteri shkencor gjendet informacioni lidhur me syllabuset që zhvillon programi të ndara në leksione, praktikë profesionale, orët brenda dhe jashtë auditorit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- syllabuset janë hartuar në përputhje me VKM 41 datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe legjislacionit Italian.</li> <li>- titullarët e lëndëve janë PAE nga universiteti “Tor Vergata në Romë” dhe nuk janë të gjithë të kategorisë profesor. <b>Bazuar në shprehjet që GVJ mori nga drejtuesit e UZKM, në aktet ligjore të universitetit Tor Vergata, titullari lëndës është pedagogu që zhvillon lëndën.</b></li> <li>- Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm si dhe literaturën që mund të shfrytëzoj studenti e cila është</li> </ul>

	në gjuhën italiane dhe angleze. Përmbajtja e programit është hartuar nga pedagogët e univeritetit Tor vergata në Romë dhe gjatë viteve pas akreditimit të dytë nuk ka patur ndryshime. Program miratohet cdo vit akademik nga rektori dhe arkivohet në institucion në gjuhën Italine. [Takimi me kordinatorin e programit dhe pedagogët].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, re zultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kreditë të miratuar nga rektori i universitetit në fillim të cdo viti akademik. 1 ETC është 25 orë mësimore [dekreti rektorit]. Shpërndarja e ETC sipas semestrave është si vijon:
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Viti i parë : semestri parë 29ETC/ 232 orë mësimore Semestri dytë 31 ETC/ 503 orë mësimore Viti i dytë : semestri parë 20ETC/ 160 orë mësimore Semestri dytë 31 ETC/ 575 orë mësimore
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Ngarkesa mësimore vjetore nuk është uniforme. Semestri i dytë i cdo viti është më i ngarkuar në orë në auditor dhe ECTS. Referuar planit mësimor praktika profesionale e cila ka një numër të konsiderueshëm kreditesh ECTS zhvillohet në semestrin e dytë (15 ETC dhe 375 orë mësimore në secilin vit akademik). Raporti ECT/orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 1/2 orë në auditor/orë studimi individual).
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Ndarja në kategori (A në E) dhe ngarkesa në krediteve (në%) për veprimtaritë formuese përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe legjislacionit italian. Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fushën e infermieristikës dhe obsetrikë, organizmit dhe administrimit, kërkimit shkencor, fushën e mësimdhënies në shëndetësi si dhe zgjidhjen e probleme të vecanta strukturat
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	
<b>Kriteri 6.</b> Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të	

5 viteve të fundit.	shëndetësore spitalore apo parësore dhe përshtatjen e tyre në tregun e punës. <b>[programi, rregullorja e FM.]</b>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme.
<p><b>Kriteri 8.</b> Përbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	Me njohuritë e mara në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e mara janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre në fushëm e organizimit, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. <b>[takimi me studentë].</b>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orëmësimore përputhet me profilin e programit të studimit. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i ngjashëm me programe ndërkombëtare anëtare të BE duke ju krijuar mundësi punësimi studentëve jo vetëm në Shqipëri dhe Itali por dhe vende të tjera të BE.(Referuar takimit me stafin drejtues të UKZKM dhe stafin akademik, programi mësimor).
<p><b>Kriteri 10.</b> Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Programi i studimit është me kuota të mbyllura cka nënkupton se nuk mund të kryhet transferime pas fillimit të këtij program studimi. Njohuritë e mara në këtë program dhe kurikula e tij ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat.</p> <p>Hartimi dherishikimi i programit të studimit kryhet nga pedagogët italianë në bashkëpunim me ata shqiptarë bazuar në legjisllacionin e dy vendeve partnere <b>[takimi me stafin akademik dhe kordinatorin e programit].</b></p> <p>Përbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përfutuara në ciklin e parë të studimit dhe orientimin e tyre në një fushën më të specializuar të infermierisë dhe obsetrikës lidhur me organizimin, administrimin, kërkimin shkencor dhe mësimdhënien. Programi i studimit ju mundëson studentëve përfitimin e shprehive, aftësive dhe kompetencës së nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre dhe përshtatjen me tregun e punës.</p> <p>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për thellimin e njohurive në fushën përkatëse të kërkimit shkencor dhe krijon bazën për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të doktoratës. <b>[programi, rregullore, plani studimit]</b></p> <p>Hartimi dhe strukturimi i përmbajtjes së programit bëhet me</p>

	<p>propozim të stafit akademik shqiptarë ose Italian duke ju referuar nevojave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar për infermier të specializuar, interesimit apo kërkesave të studentëve për tu përfshirë në kërkim shkencor. Propozimet ndërmjet dekanit të vëndit propozues i përcillet universitet partner për diskutim dhe marrje mendimit. Më tej këto ndryshime i paraqiten ministrisë së arsimit dhe shkencës në Shqipëri apo Ministrisë së arsimit, universiteti dhe këshillit të të kërkimit shkencor në Itali për miratim.</p> <p><i>Dëri me tani ky program studimi nuk pësuar ndryshime që nga momenti i licensimit, pavarësisht rekomandimeve që mund të jepen nga Instucioni Arsimor Shqitar vendimmarrja i takon Institucionit partner, pasi ky është një program i përbashkët dhe është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor Italian .[takimi me stafin drejtues dhe studentët]</i></p> <p>Program i studimit ka një harmonizim të orëve teorike e praktike çka ju mundëson studentëve thellimin e njohurive në fushën e kërkimit shkencor dhe përgatit bazën e dijeve për vazhdimin e doktoraturës.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>



### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin master shkencor në infermieristikë dhe obsetrikë përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Ai përbëhet nga pedagogë me eksperiencë që kanë kualifikimin e duhur profesional për lëndët përkatëse që ata zhvillojnë në program [Cv e stafit akademik].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik efektive dhe me kontratë i angazhuar për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit “Master shkencor në infermieristikë dhe obsetrikë” për vitet akademike 2015-2021 zotërojnë tituj akademik dhe gradën shkencorë doktorë, eksperiencën mësimdhënie si dhe kompetencën profesionale dhe akademike, që përputhet me lëndët që ata zhvillojnë në këtë program mësimor. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se në vite</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha akademike-kërkimore</p>	

<p>e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>ka ritje të stafit akademik me tituj dhe gradë shkencore në vite. Personeli akademik efektive zhvillon rreth 80% të ngarkesës mësimore të programit. Të dhënat në shifra janë pasqyruar në standartit II.2 [tabelat përmbledhëse].</p> <p>Një pjesë e rëndësishme e programit mësimor është praktika profesionale e cila ka 15ETC cdo vit akademik dhe realizohet në semestrin e dytë. Praktika realizohet sipas syllabusit përkatës dhe mbikqyret nga pedagogë të programit, personi i kontaktit në strukturat shëndetësore ku realizohet praktika profesionale me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. Viti i studimit përmbyllet me temën e diplomës. Procedura që ndiqet për miratimin, zhvillimin dhe mbrotjen e temës së diplomës janë të miratuar me rregulloren përkatëse të miratuar nga dekani i fakultetit të mjekësisë. Për realizimin e orëve të praktikës mësimore laboratorike institucioni ka angazhuar staf ndimes akademik teknik i cili përgjigjet për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, organizimin dhe zhvillimin e praktikës mësimore laboratorike duke ju asistuar studentëve dhe pedagogëve.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi II.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Institucioni i kushton një vëmendje të rëndësishme hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit në bashkëpunim të stafit akademik duke bazuar në studimin e tregut të punës kombëtar dhe më gjërë. Për realizimin e programit mësimor institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Tor Vergata, Spitalin Universitarë të Traumës, Qendrën Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’, Spitali rajonal Durrës, Spitali rajonal Elbasan, Urdhërin e Infermierit të Shqipërisë, Spitali Hygea.</p> <p>Gjatë takimit që patëm studentë që ndjekin këtë program studimi u shprehën se ky program do ju shërbejë për rritjen profesionale dhe fitimin e një pozicion më të mirë pune, për përfshirjen e tyre në</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>punë kërkimore shkencore apo proces mësimdhënie. Nevoja për infermier të kualifikuar është në rritje çka doli në pah dhe gjatë periudhës së pandemisë nga Covid 19.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Institucioni mban kontakte me studentët nëpërmjet sistemit të Alumni-t nëpërmjet të cilit konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe marrin prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit si dhe informacion për nevojat e tregut të punës për infermier të specializuar.</p> <p>Riorganizimi apo përmirësimi i programeve të studimit bazohet në propozime që vijnë nga stafi akademik shqipatë apo Italian bazuar në informacionet e përftuar nga bashkëpunimet me institucionet publike apo private, kërkesat dhe nevojat e tregut të punës për specialistë shëndetsësor në fusha të specializura, në përfudimet apo rezultatet e kërkimit shkencor në universitet. Pjesë e punës kërkimore shkencor janë temat e diplomës së studentëve që hartohen dhe realizohen me pedagogët të institucionit. Për mbledhjen e të dhënave përdoret informacion i marrë në institucionet shëndetësore në bazë të marrveshjeve të bashkëpunimit që ka institucioni për kryerjen e praktikës profesionale apo kërkimit shkencor nga studenti.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.7</b></p>	
<p><b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit “Mastër shkencor në infermieristikë dhe obsetrikë” ka si objektiv kryesor formimin e specialistëve dhe profesionistëve të rinj sipas standarteve europiane, të zhvilloj dhe nxisë kërkimin shkencor bazë dhe atë të zbatuar, të nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor duke u mbështetur në prioritet strategjike dhe zhvillimin ekonomik të vëndit.</p> <p>Njësia kryesore bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin mësimdhënie, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	




	dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike			
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Program i studimit i motivon studentët të përfshihen në punët mirëfilltëprojektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët gjatë studimeve në këtë program përfshihen në projekte të ndryshme me pedagogët e tyre si në mbledhjen e të dhënave, organizimin apo ndjekjen e seminare, konferencave shkencore dhe trainuese, publikimin e punimeve në revistën shkencore të fakultetit apo revista të tjera.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Ky program studimi është fokusuar në identifikimin e problemeve në fushën e kërkimit dhe ato klinike, aplikimin e strategjive të organizimit dhe drejtimit të strukturave shëndetësore, burimeve njerëzore dhe sistemeve të vlerësimit të ngarkesës së punës, thellimin e sistemeve të vlerësimit të akreditimit profesional dhe zbatimin e politikave dhe projekteve të përbashkëta në fushën e studimit dhe kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal.			
<b>Kriteri 5.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme	Për koordinimin, organizimin dhe realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimor shkencore institucion ka ngritur njësinë e projekteve dhe kërkimit shkencor të cilat mbështesin dhe informojnë stafin akademik në përfshirjen e tyre në thirrjet që organizon institucioni për thithjen e projekte të ndryshme me fonde të brendshme të vetë institucionin apo me fonde nga burime të tjera financimi kombëtare apo ndërkombëtare. Me fonde të vetë institucionin janë fituar 25 projekte ku një prej tyre është fituar nga ky program studimi: "Self care" në sëmundjet kronike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.8</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UKZKM i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje të veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Këto i shërbëjnë studentëve dhe stafit të universitetit për thellimin e njohurive, përfitimin e aftësive tekniko shkencore që ndikojnë në ritjen e tyre profesionale akademike dhe kulturore si dhe në plan më të gjërë përmirësimit të cilësisë së sistemit arsimor, sistemit
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur	

<p>kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>shëndetësor në drejtim të menaxhimit klinik dhe epidemiologjik. Për realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore UKZKM angazhohet me anë të finacimit të tyre me fonde të brëndshme të vetë institucionit si dhe bashkëpunimit me institucione publike dhe jo publike vëndase dhe të huaj apo kërkim shkencor për llogari të palëve të treta ku me anë të strukturave dhe kapaciteve teknike shkencore të veta mund të kryejë studime, kërkime konsulenca për llogari të palëve të treta apo përfshirjes së tyre në projekte të përbashkëta. Universiteti çdo vit vë në dispozicion të kërkimit shkencor një fond të veçantë që ndahet sipas programeve të përcaktuar nga departamenti dhe miratuar nga senati akademik dhe bordi administrimit.</p> <p>Për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafin për thirjet e projekteve me fonde të brëndshme të institucionit apo fonde nga burime të tjera. Asiston stafin në shkrimin dhe përgatitjen e projekteve dhe pas miratimit monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Pjesë e këtyre projekteve janë dhe studentët të tre cikleve të studimit.</p> <p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësi kryesore në fusha dhe probleme të vecanta të mjekësisë si sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, dhurimi gjakut etj. Studentët janë pjesëmarrës aktive në këto aktivitete nëpërmjet parqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qënë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




## II. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

### Standardi III.1

**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.

UKZKM ka hartuar rregullore për funksionimin e institucionit dhe programit të studimit të miratura nga titullari i institucionit [rregulloret]. Këto rregullore përcaktojnë elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimin të njohurive.

**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në program e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online. Masteri shkencave në infermieri dhe obsterikë synon thellimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave në drejtim të organizimit dhe koordinimit, menaxhimit, kërkimit shkencor, edukimit dhe trainimit profesional në fushën e infermieristikës dhe obsetrikë.

Në funksion të këtyre objektivave çdo vit institucioni zhvillon takime me stafin pedagogjik për identifikimin e metodologjive të përshtatshme dhe inovative sipas specifikave të lëndëve për ta bërë mësimnxënien nga studentët sa më efektiv dhe tërheqëse. Në funksion të programit mësimor janë qendra e simulimit dhe laboratorët mësimorë që mundësojnë sigurimin e metodave teorike dhe praktike të mësimdhënies në lëndë të ndryshme si rehabilitimi, asistenca mjekësore, zbatimin e bazave metodologjike të kërkimit shkencor, hartimin e modeleve organizimi të strukturave shëndetësore etj. [rregulloret, takimi me stafin akademik dhe studentët].

Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC që është në vartësi të dekanit të njësisë kryesore dhe kryhen monitorimin në mënyrë periodike të personelit akademik dhe administrative. NJSBC monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik bazuar në pyetësorin e studentëve reth aftësive mësimdhënëse të pedagogëve dhe logjistikës në dispozicion të procesit mësimor, ndjekjen e orëve mësimor në auditor, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit si dhe intervistës individuale me secilin pedagog të brëndshëm apo të jashtëm lidhur me kryerjen nga pedagogu të të gjitha detyrimeve kontraktuale me cilësinë dhe sasinë e duhur. Rezultate e përfitura nga këto vlerësimi shërbejnë si bazë për rekomandime dhe përmirësime të mundëshme të metodave të mësimdhënies. [RVB, takimi me stafin akademik, formularët e

	<b>vlerësimit].</b>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni në mënyrë periodike çdo vit vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet realizimit të plotësisht të vlerësimit nga studentët. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik, problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik si dhe logjistikën në funksion të programit të studimit. Për marrjen e mendimit nga studentë kordinatori i programit organizon takime me studentë një herë në muaj. Këto takime shërbejnë për marrjen e opinionit të studentëve dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies, monitorimin e procesit mësimor si dhe vlerësimin nga studentët të cilësisë së shërbimeve të mara nga administrata e institucionit.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	NJSBC përgatit raportin përfundimtarë mbi vlerësimin e bërë nga studentët, aktivitetin akademik, kërkimor shkencor dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni dhe ja vë në dispozicion rektorit dhe senatit akademik. Rezultatet për vlerësimin e dhënë nga studentët bëhen publike për të gjithë stafin akademik në formë të personalizuar. Rezultatet dhe informacionet e marra nga sondazhet i shërbejnë përmirësimit të punës në institucion dhe të stafit akademik, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe zbatimit të metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve [takimi me NJCBC].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	Për promovimin e shembujve dhe praktikave më të mira institucioni përdor mënyra të ndryshme si mbështetje për pjesëmarrje në trainime apo konferenca shkencore, botime të punimeve të tyre në revista shkencore, etj. [takimi me stafin akademik, NJSBC].			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përbushjes</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi studimit përdor metoda të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, përgatitjen e detyra kurse, tema diplome, punë kërkimore në laborator, praktika klinike si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. [RBV, takime

<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p><b>stafin akademik].</b></p> <table border="1" data-bbox="746 271 1236 696"> <thead> <tr> <th>Msc</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>I. Viti pare</b></td> <td><b>1500 orë</b></td> </tr> <tr> <td><b>Në auditor</b></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Leksione</td> <td>360</td> </tr> <tr> <td>Praktika profesionale</td> <td>375</td> </tr> <tr> <td><b>Punë e pavarur e studentit</b></td> <td><b>765</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td><b>II. Viti dytë</b></td> <td><b>1500 orë</b></td> </tr> <tr> <td>Leksione</td> <td>302</td> </tr> <tr> <td>Praktika profesionale</td> <td>375</td> </tr> <tr> <td><b>Punë e pavarur e studentit</b></td> <td><b>823</b></td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej I+II</b></td> <td><b>3000</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>*) Prova finale 150 orë është llogaritur si punë e pavarur e studentit (3.Plani mesimor i Tor Vergates MSc Infermieirstike.pdf)</p> <p>Nga takimi me stafin akademik u shpega që programi mesimor pasqyrohet vetëm në leksione sepse ndarja në leksione dhe seminar bëhet nga pedagogu vetë gjatë zhvillimit të lëndës. .</p> <p>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në Poëer Point, biseda interaktive me studentët apo prezantimi i temave të vecanta nga studentët dhe diskutimi i tyre, demonstrimi i procedurave të vecanta në qëndrën e simulimit, menaxhimi të një rasti klinik, asistencë ndaj pacientit etj. Stafi akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimimit apo praktikës mesimore.</p> <p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mesimore të cilat bëjnë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre ne funksion të formimit të tyre profesional teknik. Në funksion të procesit mesimor dhe aktivitetit kërkimor janë qëndra e simulimit, laboratorët mjekësor të anatomisë makroskopike, laboratorri i mikroskopisë, laboratorri infermierisë dhe salla e mësimimit autonom[dokumneti 21. laboratorët e disponueshëm, vizita].</p> <p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje ne konferenca shkencore, aktivitetet trainuese, përgatitje të projekteve dhe financim të tyre me fonde të universitetit, përfshirjen e tyre në marveshje bashkëpunës me institucione publike apo jo publike.</p> <p>Personeli akademiki angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje</p>	Msc	Në total	<b>I. Viti pare</b>	<b>1500 orë</b>	<b>Në auditor</b>		Leksione	360	Praktika profesionale	375	<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>765</b>			<b>II. Viti dytë</b>	<b>1500 orë</b>	Leksione	302	Praktika profesionale	375	<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>823</b>	<b>Gjithsej I+II</b>	<b>3000</b>
Msc	Në total																								
<b>I. Viti pare</b>	<b>1500 orë</b>																								
<b>Në auditor</b>																									
Leksione	360																								
Praktika profesionale	375																								
<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>765</b>																								
<b>II. Viti dytë</b>	<b>1500 orë</b>																								
Leksione	302																								
Praktika profesionale	375																								
<b>Punë e pavarur e studentit</b>	<b>823</b>																								
<b>Gjithsej I+II</b>	<b>3000</b>																								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>																									
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>																									
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>																									
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimimit.</p>																									
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënies të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>																									

	<p>profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperincë mjeksorë apo petagogjike në lëndët që zhvillon. <b>[CV e stafit]</b>. Institucioni ka të siguar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj.</p> <p>Institucioni vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit, takimet mujore të studentëve me koordinatoren e programit ku studentët shprehin mendimin e tyre me metodat e mësimdhënies, aftësit e pedagogëve por dhe sjellen e tyre me studentët sa mbështeten ata prej pedagogëve <b>[pyetësore me studentët]</b></p> <p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqës për studentin stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie si me anë të projektorëve, prezantime poëer point, metoda interaktive, përdorimi i apo metodat online duke shfrytëzuar sistemin LSM që janë të përdorshme si për studentët dhe pedagogët, përfshirjete tyre në trainime dhe konferenca shkencore, apo projekte sëbashku me pedagogët e tyre.</p> <p>Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët e tyre sinë zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesorë të shërbimit shëndetësor sidomos në specialitet që përputhen këtë programi <b>[takimi me studentët dhe stafin akademik]</b>.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b> <b>X</b>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Proçesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	UKZKM ka siguar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur. <b>[vizita e ambienteve]</b>

<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Në UKZKM ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë infrastrukturën fizike dhe logjistikën e nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimin, si laboratorë mjekësorë mësimorë qëndra e simulimit të cilët ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies [<b>vizita e ambienteve</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, referenca për literaturë në gjuhë të huaj në formë elektronike, sistemin online UMS dhe LMS ku ata mund të gjenë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, leksionet, librat si dhe literaturën e nevojshme në gjuhën italiane dhe gjuhën angleze.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë për programin e studimit gjëndet në librarinë dhe bibliotekën e Universitetit të printuara ose format elektronik. Në fund të çdo syllabusi studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën italiane apo gjuhë të tjera të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor. Për rastet kur mungon literatura ajo ju vëhet në dispozicion nga pedagogu në formë elektronike. Literatura e vënë në dispozicion të studentëve është e viteve të fundit. [<b>syllabuset, vizita e ambienteve, takime me stafin akademik dhe studentët</b>].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën. Gjatë vizitës në bibliotekë dhe takimet me stafin akademik GVJ konstatoi se në bibliotekë dhe librarinë e universitetit gjëndet një numër i mjaftueshëm librash si për studentët dhe pedagogët. Në blerjen e librave institucioni mer parasysh kërkesat dhe nevojat apo sygjërimet e studentëve dhe stafit akademik. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga studentët apo stafi akademik biblioteka ka infrastrukturë të duhur dhe zotëron poste leximi, kompjutera, ambienti është i mbuluar me ëireless. Biblioteka përditësohet vazhdimisht me literaturën e fundit. Librat mësimorë janë në gjuhën italiane [<b>vizita e ambienteve në institucion</b>].</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni i siguron Studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë si dhe gjetjen e burimeve online të informacionit të gjetura nga vetë studentët apo stafi akademik. Burime ndërkomëbtare elektronike për libra apo artikuj shkencorë të siguruar nga universiteti janë OPAC dhe CDD apo shkëmbimet</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni i siguron Studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë si dhe gjetjen e burimeve online të informacionit të gjetura nga vetë studentët apo stafi akademik. Burime ndërkomëbtare elektronike për libra apo artikuj shkencorë të siguruar nga universiteti janë OPAC dhe CDD apo shkëmbimet</p>

	<p>nga donacionet endryshme <b>[sigurimi I dokumentave]</b>.</p> <p>Në dispozicion të studentëve për realizimin e procesit mësimorë dhe detyrave të kursit, temave të diplomës apo aktivitetit kërkimor janë laboratorët mësimorë mjekësorë, laboratorin informatikës që gjendet në godinën kryesore.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Për mënyrën e përdorimit të sistemit online, institucioni ka dhe udhëzuesit përkatës në funksion të studentëve dhe stafit akademik. Institucioni ka në funksion të procesit mësimor, realizimit të detyrave të kursit apo temave të diplomës laboratorin mësimorë të informatikës/statistikës të paisura me kompjutëra me 48 laptop, videoprojektorë dhe foni. Në ndihmë të studentëve biblioteka ka në dispozicion dhe kërkimin në site të vecanta sic është Hinnari , një projekt bashkëpunimi që ky institucion shfrytëzon prej shumë vitesh. Në kuadër të projektot Gradua në biloteke janë shtuar dhe dy hapsira të reja me kompjutera për petagog dhe studentët që janë në dispozicion gjatë gjithë ditës. <b>[vizita e ambienteve në institucion, takimet me stafin]</b>. Në situatën e re të mësimit online universiteti po instalonn PC të dedikuara dhe monitor tach screen në 33 klasa mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>	<p>Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni ka në përdorin sistemin e menaxhimi të universitetit UniMS, ku gjendet në formë digjitali gjith informacioni shresorë i univesritetit si sekretarisë mësimore/regjistri i studentëve i cili mund të shkarkohet për shfrytëzimin shkresorë të dhënave, burimeve njerëzore apo platformë në funksion të mësimdhënies on line dhe në distancë pra gjithë informacioni akademik dhe ai administrativë. Ky sistem manaxhon dhe koordinon të gjithë aktivitetit e universitetit. Në këtë sistem janë të integruar portali i studentit, portali i bibliotekës, modilin real time classroom i cili është një modul qe lidhet me monitor të vendosur në cdo ndërtesë dhe jep infomacion të vazhdueshëm për gjëndjen e klasave, petagogëve, programin e studimit, lëndën, orarin mësimor. Portali i studentëve gjenden dhe në aplikacionin student app. ku studenti gjen shërbimet e ofruara ndaj tyre. Për të gjithë sistemet UniMs dhe satelitët e tij zyra e IT trainion vazhdimisht stafin akademik dhe studentët. Për të lehtësuar përdorimin e sitemin on linë gjatë kohës së pandemise COVID 19 janë vënë në dispozicion 2 paisje të reja:</p> <p>-Google clasroom që është intergruar me Goole meeteing dhe UniMS që mundëson zhvillimin e mësimit në 3 skenarë të :</p> <p>-provimi onlinë që mundëson zhvillimin onlinë të provimeve .</p>



mësimdhënies.	përcakton nevojat me staf akademik, propozon kriteret për përzgjedhjen e tyre në procesin mësimor, propozon shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas ekspertizës dhe kompetencës profesionale, miraton silabuset, monitoron realizimin e procesit mësimor sipas plani të miratuar, vlerëson procesin e mësimdhënies etj[rrregullorja e UKZKM, Regullorja e fakultetit dh eprogramitt të studimit].
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Njësia kryesore ku zhvillohet ky program studimi mbështet dhe nxit pedagogët të përdorin metodave inovative dhe alternative në procesin e mësimdhënies. Hartimi i sylabuseve bëhet sipas një formati të miratuar ku një rubrikë e vecantë është prezantimi I metodës së mësimdhënies apo materialeve audivizive që duhet të zbatohen gjatë procesit mësimor, përzgjedhjene e literaturës së nevojshme. Vetë institucioni organizon trainime me stafin akademik dhe atij mbështetës në procesin mësimor për aspektet didaktike të mësimdhënies duke inkurajuar përdorimin e metodave të ndryshme sipas tipologjisë së lëndës. Gjith ku proces bazohet në rregulloret e institucionit dhe programit të studimit. <b>{takimi me stafin akademik, regullorja e UKZKM, rregullorja e programit të studimit}.</b>
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Institucioni nëpërmjet NJSBC në bashkëpunim dhe njësitë bazë ku zhvillohen programe të ndryshme të studimit, siguron një program trajnimi për stafin akademik në përputhje me kualifikimin e tyre. Kualifikimet zhvillohen me anë të përfshirjes së tyre konferenca shkecore, trainime, organizmim dhe manaxhim të projekteve dhe kërkime. Gjithashtu, personeli akademik përfiton nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve apo përfshirjen në projekte kërkimore shkencore <b>[lista e aktiviteteve, marrveshjet].</b>  Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies njësia bazë mbështet eksperimentin dhe futjen e metodave të reja inovative në realizimin e procesit mësimor me futjen e sistemeve kompjuterike njësit bazë bashkërendojnë më njëri tjetrin në organizmin e trainimeve me stafin dihmës akademik të angazhuar në realizimin e procesit mësimorëdhe veprimtarinë kërkuese për përmirësimin e vazhdueshëm të metodave didaktike. <b>[Takimi me drejruetit e FM dhe stafin, kordinatorin e programit].</b>  Në zhvillimin e procesit mësimor duke u mbështetur në lirinë akademike pedagogu teston metoda të ndryshme mësimdhënie sipas lëndëve të vecanta. Metodatat eIT mundësojnë përdorimin e mjeteve ndihmëse që lejojnë bashkëpunimin student pedagog si klasat e

	<p>simulimit, leksione, seminare takime me anë të platformave IT online si zoom, meeting, ëebinar. Eksperiencat e reja diskutohen dhe rezultatet e tyre paraqiten në department duke shpërndarë eksperiencës me kolegët. Këto i shërbejnë zbatimit të metodave të reja dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. <b>[takimi me stafin drejtues dhe akademik].</b></p> <p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, realizimit të konferencave ndërkombëtare të përbashkëta me universitet dhe institucione Italiane, realizimin e botimeve në buletin shkencorë të institucionit, pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore <b>[takimi me stafin drejtues dhe akademik, revista e univesitetit, lista e aktiviteve ]</b></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe takimet e zhvilluar në institucion me studentët, pedagogë dhe stafin mbështetës akademik konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve dhe aftësive profesionale të stafit bazohen në rregulloren e programit të studimit. Studentët njihen me këto rregullore në fillim të vitit akademik nga koordinatori e programit dhe zyra e kujdesit ndaj studentit, si dhe nga pedagogu i lëndës në fillim të syllabusit përkatës. Provimet zhvillohen me gojë, shkrim ose të kombinuara. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme, bëhet me pikë nga 18 pikë minimumi deri 30 pikë maksimalja <b>[takime me stafin, rregulloret e Fakultetit dhe programit të studimit].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara	Në fillim të lëndës pedagogu prezanton syllabusin e lëndës, mënyrën e realizimit të procesit mësimor, tematikën e leksioneve, seminareve dhe praktikave laboratorike dhe orët mësimore përkatëse sipas ETC që ka lënda. Pedagogu informon studentit për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësimt të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor është i detyrueshëm në masën 80% të orëve. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme sipas rregullores së programit mësimor. Gjith informacioni ju vihet në dispozicion studentëve në sitemin

	UminMS [takime me stafin, rregulloret programit të studimit, sylabuset].			
	Vlerësimi i dijeve dhe aftësive profesionale kryhet në mënyrë të vazhdueshme sipas specifikës së lëndeve dhe përfshin: provim me shkrim gojë ose të kombinuar, ese, projektë, detyra kursi, apo mënyra të tjera vlerësimi. Vlerësimi i kombinuar mundeson studentit të demonstronjë dijet dhe aftësitë e fituara [regullorja e provimeve].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihet këtyre të fundit në dispozicion në platformën uminMS[regulloret e funksionimit të Fakultetit të mjekësisë dhe programit të studimit, rregullorja e provimeve ]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullore përkatëse. Elemente kryesore të kontrollit të dijeve janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në tre sezone: sezoni dimrit, verës, vjeshtës.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Komisioni i vlerësimit të provimit përbëhet së paku nga dy pedagogë ku njëri është pedagogu i lëndës. Për lëndët e integruar që kanë më shumë së dy module komisioni përbëhet nga pedagogët që kanë zhvilluar modulet. Komisioni vlerësimit propozohet nga kordinatori programit në bashkëpunim me pedagogët e lëndës dhe miratohen nga dekani.
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	Vlerësimi i dijeve bëhet sipas sistemit të pikëzimit minimum 18/30 dhe maksimalja 30/30 pikë. Për lëndët e integruara vlerësimi bëhet me mesataren e pikëve të marra nga vlerësimet në cdo modul [Rregullore e provimeve, rregullorja e fakultetit të mjekësisë].  Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar dhe procesi i provimit bazohet në rregulloren e programit të studimit. Kur provimi bëhet me shkrim procesi është anonym me sekretim. Në vitin e fundit institucioni ka zbatuar provimin on line sipas rregullore së provime on line të hartuar nga sektori It dhe miratuar nga dekani. Studentët dhe pedagogët janë njohur me rregulloren përpra fillimit të sezonit të provimit. Studenti hyr në sistemin elektronik në platformën Exam online,

në terminal student. Sistemi ka të gjitha rregullat e sigurisë për zhvillimin e provimit online me gojë dhe shkrim. Sistemi është në monitorim të vazhdueshëm nga specialistët e IT për të siguruar cilësisë dhe sigurinë gjatë zhvillimit të provimit **[Rregullore e provimeve, dok 46 Procedura e provimit dh e diplomimit]**.

Testimi i dijeve përfundimtarë realizohet nga pedagogu që ka zhvilluar lëndën. Komisioni i provimit bëhet minimumi nga dy pedagogë ku njëri është pedagogu u i lëndës dhe miratohet nga dekan i fakultetit të mjekësisë. Procedura e kryerjes së provimit bazohen në rregullorene programit të studimit.

Student hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për cdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Studenti paraqitet në provim me dokument identifikues dhe cdo objekt që ka me vete vendoset nënjë vënd të caktuar nga organizatorët. Në provim janë të pranishëm pedagogët e lëndës, kordinatori që kryhen sekretimin, monitorues nga departamenti dhe dekanati. GVJ nga verifikimi me sondazh i fletëve të provimit dhe takimi me përfaqësuesit e kurikulave konstatoi se procedura e provimit kryhet sipas rregullores përkatëse, proces verbale janë me dy firma. **[proces verbali i provimit, regjistrat e provimt, rregullorja e FM, rregullorja e provimit, takimi me koordinatoren e programit]**.

Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë ose I kombiruar. Kalendari I provimeve për cdo sezon shpallet në sistemin elektronik dy javë përpara zhvillimit të provimit. Studentët duhet të regjistrohen në portal 7 ditë përpara zhvillimit të provimit. Gjithashtu on line shpallet dhe infrastruktura për realizmin e provimit (sallat e provimit, ora, pedagogu që zhvillon provimin dhe cdo informacion tjetër lidhur me zhvillimin e provimit). Provimi me shkrim është anonim dhe me sekretim, pikët e vlerësimit vendosen në fletët e provimit nga pedagogu i lëndës dhe dorëzohen në sekretarinë mesimore e cila bën c'sekretimin. Vlerësimi i studentit me pikë është i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve dhe firmoset nga pedagogët që ka bërë korrigjimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit. Për mbarëvatjen e procesit të provimit, sekretaria vë në dispozicion të pedagogut dhe regjistrin e provimit ku janë të regjistrua studentë që hyjnë në provimin e lëndës, në kolonën përkatëse studentit firmos në fillim të provimit për prezencën e tij në provim. Nëse provimi është me gojë në një kolonë të vecante shënohen dhe pyetjet që i drejtohen studentit. Nëse provimi është me shkrim dhe gojë, studentit kalon me gojë pasi mer pikët e nevojshme të caktuara në vlerësimin me shkrim. Nëse studentit është vlerësuar kalueshëm në provimin me shkrim por nuk paraqitet me gojë ai nuk klasifikohet kalues.



	<p>Pas përfundimit të provimit nëse studenti nuk është dakord me vlerësimin nënshkruan në regjistrin e provimit në kolonën që nuk është dakord dhe kërkon rivlerësim. Në përfundim të procesit të vlerësimit pedagogu shënon datën e provimit, orën e fillimit dhe mbarimit dhe nënshkruan për procesin. Regjistri dorëzohet në sekretari sëbashku me fletët e provimit. <b>[regullorja e provimit].</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i provimit ka si qëllim të vlerësoj dijet e përfuara nga studenti gjatë programit të studimit, ku ai duhet të përqëndrohet dhe të mësojë më tepër. Për këtë qëllim vlerësimi i provimeve ka dhe komente sqaruese. Vlerësimi i dijeve duhet të stimulojë studentin dhe motivoj atë për të mësuar më shumë dhe jo ta penalizoj dhe demoralizoj atë <b>[regullorja e provimit].</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>UKZKM ka vendosur dhe zbaton prej vitesh systemin elektronik antiplagjiaturë për të shmangur kopjimin në detyrat e kursit, punime të diplomës apo doktoraturës. <b>[takimi me stafin akademik, drejtues dhe RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Shkalla e përvetësimit të dijeve dhe aftësive profesionale me shkrim dhe / ose me gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit dhe në përputhje me specifikën e lëndës bëhet në bazë pikëzimi me 30 pikë. Rezultatet e provimit ju komunikohen studentëve në kohë duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit <b>[regullorja e provimit, takimi me stafin dhe studentët].</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Student kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin dhe për këtë ai nënshkruan në regjistrin e provimit që konteston vlerësimin. Procedura e shqyrtimit të ankesës përcaktohet në rregulloren e provimeve ku pas kontestimit të studentit provimi rishikohet nga një komision i miratuar nga dekan. Nëse studenti nuk është dakord me rishikimin e komisionit i drejtohet dekanit me kërkesë me shkrim. Vendimi që merret pas rishqyrtimit nga dekan është i pakontestueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Student shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve <b>[takimi me studentët, regullorja e provimit].</b></p> <p>Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës të miratuar në rregulloren përkatëse të provimit.</p>

	Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit të ngritur në rang programi. E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore, dhe në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm [takimi me studentët, regullorja e provimit].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë Mastër shkencor infermieri është me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ka 120 ECTS në total. Një vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. 1 ECTS = 25 orë punë studentit në auditor dhe jashtë auditorit. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, apo prezantime apo praktika profesionale. Ngarkesa mësimore e cdo pedagogu në planin mësimorë pasqyrohet vetëmme leksione por pedagogu ka liri akademike të organizoj vetë ndarjen e lëndës në leskione dhe seminare. Organizmi i programit mësimor si dhe kurikulat e programit/syllabuset/lëndët mësimorë mundësojnë formimin profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të vecanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup etj [regullorja e programit, plani mësimor].			
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Pjesë të programit mësimor përvec lëndëve të formit profesional janë dhe ato të formit të përgjithshëm si metodat e kërkimit shkencor bazë dhe të avancuar. [plani mësimor, kurikula e programit].			
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	Masteri shkencor në “Shkencat Infermieristike dhe Obstetrikë” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë infermierë me kompetencën e nevojshme profesionale teorike dhe praktike në fusha të specializuar të mjeksësisë, aftësi manaxhese dhe kërkimit shkencor.			
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e vecantë në kurrikulën e programit. Në përfundim të lëndëve të vecanta një vënd të rëndësishëm zë dhe diskutimi me studentët i përmbatjes së syllabuseve, sa ju ka shërbyer ky program studimi në formimin e tyre profesional, përfutim të			
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.				
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.				
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.				
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon				

klime të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.

**Kriteri 9.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.

aftësive dhe kompetencave në kryerjen e detyrave si dhe marrin mendimin dhe sygjërimet e studentëve për përmirësimin e programit të studimit. **[kurikula e programit, takimi me studentët].**

Në përfundim të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme orën e fundit të mësimit, pedagogu si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjithashtu pedagogu ndalet në vecanti në temat që kanë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Këto orë zhvillohen në formë diskutimeve me studentët dhe përfshirjes interaktive të tyre për sqarimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara [regullorja e programit, takimi me stafin akademik dhe studentët].

Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon trainime apo leksione, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre [lista e aktiviteteve].

Në programi Mastër shkencor në “shkencat infermieristike dhe obsetrikë” janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakteri zuese, janë Mjekë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusna. Në lëndët e zhvilluar bazuar në CV e stafit akademik që u vunë në dispozicion, fusha e ekspertizës së pedagogutpërputhet me sylabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. **[Cv e stafit akademik].**

Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminare apo aktiviteteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etike midis kolegëve. Në javën e fundit të lëndës studentët paraqesin studimin apo detyrë kursi të cilat shërbejnë si mjet për vlerësimin e aftësive të studentit dhe sa student ka përftuar gjatë programit të studimit **[takimi me studentët].**

Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundeson pedagogëve përdorimin e metodave në ndryshme në mësimdhënie, detyrave kursit apo në punimin e temave të diplomës. **[Takim me stafin akademik].**

Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të

	<p>avancuara kërkimore e shkencore nga studentë në bashkëpunim me pedagogët. Këtij qëllimi i shërbejnë dhe mbështetja që UKZKM I siguron stafit akademik në përfshirjen të pedagogëve dhe studentëve në projekte me fonde të institucionit. UKZKM me fonde të institucionit ka 29 projekte të financuar të cilat gjatë vitit të fundit për shkak të pandemisë covid 19 ka vonesë në realizimin e tyre [lista e projekteve dhe bashkëpunimeve].</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Programi Master shkencor në infermieri ka patur shkëmbime eksperiencë në kuadër të marrveshjes me institucione të tjera. Në këtë program studimi nuk praktikohen transferime të studenteve nga apo drejt programeve të tjera të ngjashme. Për këtë studentët informohen që në fillim të studimeve në këtë program studimi.</p> <p><b>[Program i studimit dhe marrveshjet].</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi III.8</b>  <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Studenti me përfundimin e studimeve pajiset me diplomë të përbashkët “Master shkencor në Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike” të UKZKM dhe “Universitetit të mjekësisë Tor Vergata” në Romë pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e diplomimit të UKZKM dhe të programit të studimit. Komisioni vlerësimi miratohet nga Rektori i UKZKM [rregullorja e diplomimit, rregullorja e punimit të diplomës].</p> <p>Fokusi i programit “Master shkencor në shkencat infermieristike dhe obstetrike” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale dhe kompetencave në ushtrimin e profesionit nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar i diplomës si detyrim përmbysës, bëhet me paraqitjen e punimit të realizura nga student, i cili synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme diplome. Për t’u pranuar në provimin e diplomimit student paraqet në sekretarin mësimor aplikimin për caktimin e temës së diplomës, deklarat e miratimit të temës nga pedagogu udhëheqës, dhe aplikimi për praninë në provimin e diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e</p>	



<p>institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Studentët asistohen nga pedagogët e programit të studimit dhe kordinatorja e programit për provimin përfundimtarëdhe zgjedhjen e e literaturës që do të shfrytëzojnë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Temat propozohen nga pedagogët dhe koordinatori i programit të studimit dhe përputhen me kurrikulën e zhvilluar në programin e studimit. Tematikat e propozuar miratohen nga dekani së bashku me pedagogun udhëheqës, emrin e studentit dhe datën e mbrotjes. Studenti dhe pedagogu njoftohen nga sekretaria mësimore <b>[punimi i diplomës, rregullorja UKZKM].</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Komisioni i vlerësimit të studentit në provimin e diplomimit miratohet nga rektori. Ky studim lidhet ngushtë me profilin që ka studjuar studentin dhe njohuritë që ai ka përfutur në këtë program studimi. Mënyra e vlerësimit përcaktohet nga komisioni provimit i cili përbëhet nga pedagogë që kanë zhvilluar lëndët e programit mësimor <b>[rregullorja e diplomimit].</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Përcaktimi dhe miratimi i temave të diplomës bëhet të paktën 9 muaj para diplomimit, në semestrit e dytë të vitit të dytë. Për të dorëzuar formularët e kërkesës së diplomimit studentin duhet të jetë regjistruar në vitin e fundit të studimit dhe të ketë shlyer detyrimet financiare ndaj fakultetit. Për tu futur në provimin e diplomimit studentin duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit mësimor, të ketë marrë ETC dhe të gjitha provimet në lëndët e programit, të ketë shlyer detyrimet financiare dhe administrative si dorëzim të librave në bibliotekë. 15 ditë përpara provimit të diplomës studentin dorëzon në sekretari librezën e studentin, miratimin e pedagogut udhëheqës të temës, punimin në hard copy dhe Cd sipas rregullores së provimit të diplomimit <b>[rregullorja e diplomimit].</b></p> <p>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave metodologjike që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimin apo prezantimin e punimit të diplomës.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi apo realizimin e pjesës eksperimentale në laboratorët e universitetit <b>[infrastruktura, takimi me stafin akademik].</b></p>

Pedagogu udhëheqës udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literaturën që do shfrytëzoj dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit. udhëheqësi I temës është nga stafi akademik dhe zotëron të paktën gradën “doktorë shkencash”. [regullorja e diplomës, Regullorja UET].

Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara komisioni të propozuar nga dekani dhe miratuar nga rektori i UKZKM. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen nga komisioni i përbërë nga 11 anëtarë me pikë/notë dhe përfshin mesataren e pikëve të mara në lëndët e programit me pikët e mara në prezantimin e temës (pikët e prezantimit të temës janë mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit). Nota shprehet me 110 pikë dhe ka minimum 66/110 pikë dhe maksimumi 110/110.

Rezultati përfundimtar shënohet në Proces-verbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet dhe bëhet në dy kopje një për UKZKM dhe një për Universitetin e mjeksë Tor Vergata në Romë.

Procedura e përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës bazohet në rregulloren e diplomimit.

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor, ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj UKZKM dhe ka përbushur detyrimet përmbysë të programit të studimit, pajiset nga institucioni me diplomën përkatëse, të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve universitare, me suplementin e diplomës të firmosur nga dy rektorët e UKZKM dhe universitetit Tor Vergata, administratorët e fakulteteve. Diploma është e miratuar nga senati dhe MASH me urdhërin nr 10, datë 30.03.2020. Deri në pajisjen me diplomë të të diplomuarve, universiteti lëshon një vërtetim për diplomën e fituar, të shoqëruar me certifikatën e notave.

Në përfundim të studimeve në këtë program studentit pajisjet dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin edytë të studimeve në Mastër shkencor në Infermieri. [programi i studimit]

Dokumentacioni lidhur me studentët ruhen nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin në të dy vëndet Shqipëri dhe Itali. Informacioni ruhet në sekretarinë mësimore dhe formë

	elektronike në sistemin UniMS [rregullore e sistemit të menaxhimit].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



### III. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këtu të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se ZKM disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “Master i Shkencave “ në Infermieri dhe Obsetrikë”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë Zyrës së Personelit në dosjet personale të stafit akademik e cila mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër. Ky dokumentacion përditësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe administrohet nga Zyra e sipërcituar së bashku me dokumentacionin e stafit mbështetës didaktik shkencor dhe administrativ. <b>[dokumentacioni i verifikuar në mënyrë rastësore].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore u përzgjedhën dy dosje në mënyrë rastësore, një nga personeli akademik efektiv dhe një me kontratë të cilat rezultuan të kompletuara konform rregullave dhe kritereve institucionale.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore të institucionit GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.

<p>përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Rekrutimi i stafit akademik shqiptar bëhet në përthutje me legjilacionin në fuqi dhe rregulloren e brendshme.</p> <p>Institucioni disponon rregullore në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga UKZKM(<b>Rregullore për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Ref 56</b>).</p> <p>Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga ZKM në cilat evidentohen qartësisht të gjitha fazat , që nga evidentimi i nevojave të cdo departamenti përcaktimi dhe shpallja e kriterive, Ngritja e një komisioni ad hoc nga Rektori, procesi i konkurimit si për stafin akademik me kontratë ashtu edhe atë efektiv, deri në përgjedhjen dhe emërimin.</p> <p>Proceset evidentohen të jenë transparente dhe kolegiale.</p> <p>Për cdo vend vakant njoftimet behen në faqen zyrtare të Institucionit, <a href="http://ëëë.unizkm.al">ëëë.unizkm.al</a></p> <p>Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës.</p> <p>Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendëshme të institucionit ZKM(<b>Rregullore për Burimet Njerëzore</b>).</p> <p>GVJ evidentoi se instucioni nuk ka rekrutuar staf të ri për të mbuluar programin Master Shkencor në INFIERMIERI DHE OBSETRIKË, programi është realizuar nga stafi ekzistues i Fakultetit të Mjellësisë.</p> <p><i>Përzgjedhja e stafit bëhet jo vetem duke marrë ne konsideratë nevojat institucionle por edhe ekspertizën e kandidatëve në fushat specifike shkencore që ato mbulojnë dhe gjithashtu aftësitë e tyre didaktike.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të</p>	<p>UKZKM ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin e me qëllim kryerjen detyrave</p>

barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	në procesin mësimdhënës dhe shkencor . Zyrat janë të mirë pajisura me kompjutera , kane ndricim dhe sisteme kondicionimi. ( vizita e ambjenteve).			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni nxit stafin akademik dhe mbështet atë përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimit të kushtëve dhe nxitjes për pjesmarrje aktive në aktivitete shkencore kombëtoare dhe nderkombetare</li> <li>- Organizimin e aktiviteteve shkencore brenda në institucion</li> <li>- Mbështetjen financiare për punë kërkimore shkencore dhe botime akademike</li> <li>- Krijimi i mundësive për shkëmbimim e përvojës më akademike të institucioneve të tjera të arsimit të lartë etj.</li> </ul>			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Institucioni ka organizuar disa aktivitete në mbështetje të zhvillimit profesional të stafit <i>por GVJ konstaton se numri i këtyre aktiviteteve nuk është i lartë, ndoshta e diktuar dhe nga situata e pandemisë, në këto kushte ne rekomandojmë shtimin e aktiviteteve shkencore si konferenca, symposiume etj. të dedikuara në fushën e mjekësisë në përgjithësi dhe atë të infermieristikës në vecanti.</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	<p>Nga takimi me personelin akademik, personeli akademik shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. <b>[takimi me personelin akademik]</b>. Gjithashtu GVJ evidentoi se institucioni me anë të stafit administrativ mbështet stafin akademik edhe me logjistikën ndihmëse, sic janë bibliotekat shërbimet kompjuterike etj.</p> <p>GVJ evidenton që personeli akademik i cili mbulon programin e studimit, ka një aktivitet shkencor të pasur si në botime shkencore ashtu dhe në prezantime në aktivitete të ndryshme të shkencave mjekësore dhe gjithashtu ka motivimin e duhur në procesin e mësimdhënies dhe të mbështetjes ndaj studenteve.</p> <p>Më anë të koordinatorit të programit Institucioni realizon optimizimin dhe menaxhimin e tërë procesit akademik dhe shkencor në funksion të programit.</p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni të vazhdojë angazhimin e tij me qëllim krijimin e mundësive konkretë për kualifikimin e vazhdueshëm dhe krijimin e mundësive për zhvillimin shkencor të personelit akademik i cili mbulon shkencat mjekësore në përgjithësi dhe programin në veçanti.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni është i organizuar në formën e Kampusit Universitar me një sipërfaqe 50.000 m <sup>2</sup> në pronësi të Fondacionit Zonja e Këshillit të Mirë. Kampusi është i vendosur larg zonave industriale dhe është i organizuar në mënyrë të tillë që të krijojë siguri dhe njëkohësisht lirëshmëri levizje për studentët.  Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Ambjentet janë me sistem kondicionimi dhe sistem ëireless, nyje hidrosanitare, sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë ku sallat e leksioneve ishin të pajisura me video- projektor, kompjuter të lidhur me internet, tabela dhe foni. Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. <b>[vizita e ambienteve]</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni disponon 10 salla leksionesh, 14 salla seminaresh, 5 laboratore mësimore informatike të pajisura me softëra përkatës në funksion të cdo programi mësimor dhe me video projektor. Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura gjithashtu me mjete audio vizive si PC, projektorë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim.  Institucioni dispononte laboratorë mësimore mjekësore dhe kabinete infermieristike në funksion direkt të zhvillimit të programit mësimor të cilët ishin të mirë pajisur.  Gjithashtu në dispozicion të studentëve është laboratori i

	<p>Informatikës me 48 labtop me programe kompjuterike te licensuara të lidhura me një server terminal. Gjithashtu në bibliotekë janë 3 PC AIO në dispozicion të studenve dhe të stafit. Në RVB dhe gjatë takimeve me drejtuesit dhe stafin u deklarua se do të shkohen dhe dy hapësira të tjera me paisura me kompjutera. Të gjitha ambientet janë të mbuluara nga rrjeti ëireless.</p> <p>Institucioni ofron gjithshu për të gjithë studentet licensat për programe të ndryshme kompjuterike.</p> <p>Institucioni në funksion të zhvillimit të praktive profesionale Poliambulancën, Qendrën për Reabilitim dhe Mjekësinë Sportive, Dhomën e Studimeve Autonome, Qendrën e Simulimit të Acancuar Mjekësor.</p> <p>Gjithashtu Institucioni ka marrëveshje bashkëpunii me Qendrën Spitalore Universitare, Spitaline Traumës, Spitalin Rajonal të Durrësit, Spitalin HYGEA, Qendrën Spitalore Xhafer Kongoli Elbasan.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e institucionit ka një sipërfaqe ka një fond librash prej 17,000 vëllime dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjetëireless, duke siguruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka funksionon në bazë Rregullore së Bibliotekës dhe është në funksion si të stafit ashtu edhe të studentëve.  Biblioteka ka krijuar një Katalog me libra elektronik në gjuhë të huaja, cilikaqindratitujlibrashnëbazëtëprogramevetëstudimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit gjithashtu ajo ofron shërbim edhe përmes portalit të saj elektronik.  Studentët mund të shfrytësojnë literaturën fizike e cila pasurohet cdo vit në bazë të kërkesave nga stafi akademik, sugjerimeve dhe gjithashtu donacioneve. Çdo fillim viti akademik behët vlerësimi i literaturës në dispozicion të programeve, përditësimi dhe
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	

<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>rifreskimi i tyre.</p> <p>Biblioteka ka zonën e saj të gazetës virtuale me tre stacione kompjuterike të cilat shërbejnë për konsultimin me bazat e të dhënave.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me poste internet, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për student dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve nga: (Hënë - Premte 8<sup>00</sup>-20<sup>00</sup>, e Shtunë 9<sup>00</sup>-14<sup>00</sup>. Salla e leximit Hënë-Diel 08<sup>00</sup>-21<sup>00</sup>.)</p> <p>Biblioteka është e hapur edhe gjatë festave zyrtare përveç festave fetare.</p> <p>Menyra e funksionit të bibliotekës, si pasurimi me tituj, oraret e shërbimit etj janë të sanksionuara në Rregulloren e bibliotekës.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuq përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UKZKM disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin UniMS.</p> <p>Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, të dhënave të aktivitetit akademik, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Të dhëna mund të shfrytëzohen dhe nga Zyra e Statistikave me qëllim monitorimin dhe përmirësimin e proceseve akademike dhe administrative.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të</p>	<p>Ky sistem bën dixhitalizimin e të gjithë informacionit dhe të dhënave të gjeneruara gjatë procesit akademik dhe gjithashtu punës administrative në Universitet. Sistemi është ndërtuar në bazë Statusit</p>





studimit.	dhe rregulloreve të UKZKM.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Universiteti ka një sistem të vëtëm menaxhimi (Enterprise Resource Planning) i cili integron dhe koordinon të gjitha aktivitetet e universitetit. Tëintegruara në këtë sistem menaxhimi janë: Portali i studentit, i cili është pika kryesore lidhëse, informative dhe bashkëpunuesë ndërmjet të gjithë hallkave të Universitetit dhe vetë studenteve. Të gjithë studentët kanë kredencialet e tyre për aksesimin e portalit. Portali i pedagogëve, në të cilin bëhet depozitimi i planit mësimor, kalendari didaktik etj. Google classroom, platforma e dedikuar për mësimdhënie online, ku gjithashtu realizohet edhe ngarkimi i materialeve mësimore nga pedagogët, ngarkimi i detyrave apo projekteve të studentëve, realizimi i testeve dhe provimeve të kontrollit. Universiteti ka faqen e internetit e cila është aktive (verifikuar nga GVJ). <i>Faqja e internetit <a href="https://www.unizkm.al/">https://www.unizkm.al/</a> ka seksione të veçanta ku mund të gjenden të gjitha informacionet dhe është në tre gjuhë: anglisht, shqip dhe italisht.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.				
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni deklaron se përgatit raporte financiare me bazë vjetore të cilat i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.  Raportet financiare të cilat i përkasin aktivitetit akademik janë pjesë përbërëse e Bilancit total të Fondacionit ku përfshihen edhe veprimtari të tjera ligjore. Të ardhurat për çdo program studimi deklarohet të sigurohen nga tarifat e studimit , të cilat përcaktohen në rregulloren e tarifave (Evidenca nr.62) , tarifat për shërbime e sekretarisë. Në planin financiar përfshihen gjithashtu shpenzimet e personelit, pagat e pedagogëve, shpenzime operative, shpenzime për investime, shpenzime për kërkimin shkencor. (Referuar Pasqyra Financiare Preventiv RVB)
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat	Institucioni deklaron se kryen auditim të pasqyrave financiare të përvitshëm, dhe çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. <i>Në dispozicion të GVJ nuk janë vendosur Pasqyra,</i>

<p>on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p><b>Raporte Financiare dhe as Raporte auditimi.</b></p> <p>UKZKM është një institucion privat i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit dhe gjithashtu nga burime financiare nga aktivitete te ligjshme të Fondacionit.</p> <p>Në dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifaf e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit) .</p> <p>Institiucioni deklaron se përgatit raporte preventive financiare cdo vit dhe gjithashtu përgatit raporte financiare për periudha tre vjecare, por GVJ nuk identifikoi analiza mbi të cilat të jenë hartuar politika apo ndërhyrjet e posaçme në buxhet për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij për vitet në vijim.</p> <p><i>Në RVB deklarohet se institucioni ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare.</i></p> <p><i>Bazuar në të dhënat e pakta që na janë ofruar por dhe në historinë e gjatë dhe performancën e këtij institucioni, GVJ del në konkluzionin që UNIZKM ka qëndrueshmëri financiare dhe garanton një ecure afatgjatë të tij dhe të programit të studimit në veçanti. (Evidenca nr.62. Rregulore e tarifave, Pasqyra Financiare Preventiv )</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifaf e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>				
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### IV. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UKZKM është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e vet në bazën ligjore aktuale në fuqi dhe dekreteve të përvitëshme të cilat dalin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin dhe rregulloren. Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Programet e studimit në UKZKM kanë kuota të kufizuara, rrjedhimisht është Senati Akademik, organi institucional i cili çdo vit mësimor përcakton kuotat për çdo program studimi dhe gjithashtu edhe kriteret e pranimit, e njëjta politike ndiqet edhe për programin e studimit Master Shkencor në Infermieri dhe Obsetrikë (<b>Evidencë 65, Kriteret dhe Procedurat për pranimit në programin e studimit Master Shkencor në Infermieri dhe Obsetrikë</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Të gjitha procedurat e pranimit publikohen në faqen e internetit <a href="http://www.unizkm.al">www.unizkm.al</a>, ku jepet informacioni i nevojshëm për tërë procedurën që nga aplikimi deri në regjistrim, informacionet vlerësohen të jenë të sakta dhe transparente (verifikuar nga GVJ)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit GVJ, vlerëson se institucioni përzgjedhjen e kandidatëve e bazon në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p><b>(Referuar , Pranimit në programin e studimit, Rregullorja mësimore).</b></p> <p>UNIZKM ndjek politika të gjithë përfshirjes teritoriale shqiptare duke synuar terheqjen studenteve nga Kosova , Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovc, duke përcaktuar kuota të vecanta për këtë kategori studentësh.</p> <p>UNIZKM gjithashtu pranon aplikime edhe nga kandidatë të huaj të cilat konkurajnë në kuota të vecanta dhe kriteret specifike bëhen publike në eeb. ( Evidenca 65).</p> <p>Të drejtën për aplikime në programin Master Shkencor në Infermieri</p>

dhe Obsetrikë në bazë të legjislacionit e kanë të gjithë kandidatët me diplomë të nivelit të parë Bachelor në Infermieristike dhe Obsetrikë tëfituar në Universitet Publike Shqiptare dhe UKZKM, Universitet ItalianE dhe të BE, Universitet e vendeve të treta vetëm pas verifikimit të përputhshmërisë së kurrikulës.

Aplikimi bëhet ne portalin universitar dhe përzgjedhja e kandtateve bëhet në dy faza: faza e parë shqyrtimi i dokumentacionit dhe faza e dytë intervista me gojë. (Referuar RVB, faqes ëeb, takimit me drejtuesit dhe stafin).

Dokumentaoni i kandidatëve fitues dorëzohet i plotë në sekretari ( **verifikuar nga GJV, dosje studentësh**),ku ndiqen procedurat përkatëse të përcaktuara në aktet rregullatore te Institucionit.

Kandidatët të cilët kanë diploma të fitura në universitete jo shqiptare i nënështrohen paraprakisht ekuivalentimit nga organizmat përgjegjes.

**Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme, të aksesueshme on-line, dhe janë pëcaktuar në rregullore dhe aktet e tjera rregullatore te IAL, informacioni jepet brenda afate ligjore dhe është transparent.**

Kriteret dhe procedurat gjithashtu ibëhentëdituratëinteresuavegjatë vizitësnëinstitucion, ndërmjet rrjeteve sociale, përmes postës elektronike dhe gjithashtu përmes aktiviteve të orgnizuara nga Ministria e Arsimit dhe nga Ambasada Italiane sic është panairi i Arsimit të Lartë.

Institucioni ndjek ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit duke zbatuar dhe ndjekur aktet rregullatore të cilat i vihen në dispozicion studentëve.

Sipas të dhënave të sekretarisë në këtë program studimi numri i studentëve është si më poshtë:

**2015-2016 -11 studente ( të cregjistruar 3 student)**

**Shqipëtarë 5, Italianë 6**

**2016- 2017 – 10 studente ( të cregjistruar 1 student)**

**Shqipëtarë 6, Italianë 4**

**2017- 2018 – 8 studente**

**Shqipëtarë 5, Italianë 3**

**2018-2019 - 8 studente ( të cregjistruar 1 student)**

**Shqipëtarë 4, Italianë 3, të tjerë 1**

**2019-2020 - 4 studente**

**Shqipëtarë 1, Italianë 3**



	<b>2020-2021 - 18 student</b>			
	<b>Shqipëtarë 3, Italianë 15</b>			
	Informacioni në lidhje me kurrikulat dhe programet që institucioni ofron vihet në dispozicion të publikut dhe shpërndahet përmes rrugëve të ndryshme të komunikimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e pranimit. Ato janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë. Programi i studimit zgjat dy vite akademike dhe institucioni ka vënë në dispozicion informacionin për kriteret e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Përcjelljen e e informacionit dhe orientimi i studentëve të vitit të parë në lidhje me planin e studimit rregullorin e studimit dhe modalitetet e suksesit e realizon Koordinatorin i programit së bashku me sekretarinë e programit të studimit, gjatë takimeve të programuara të fillimit vitit. (Evidence nr 32). Koordinatorin i programit është pranë studenteve në çdo kohë, me qëllim asistencën e tyre gjatë tërë periudhës së studimit deri në diplomim. (Evidenca 32. Detyrat e koordinorit, takimi me studentet).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në aktet rregullatore të UKZKM, ( Evidenca 53, 36. Rregullore e programve të dyta të studimit, Rregullore për transferimin e studimeve) janë evidentuar qartësisht , kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe modalitetet e transferimit nga shkolla të tjera universitare dhe njëkohësisht modalitetet e transferimit të studenteve të UNIZKM drejt shkollave të tjera universitare.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	<i>Në rastin e programit Master Shkencor në Infermieri dhe Obsetrike nuk ka transferime gjatë ciklit të studimeve pasi ky program është një program me kuota të mbyllura, por mund të realizohen njohje të krediteve nga studimet e mëparshme të studimeve të nivelit të dytë.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni në fillim të vitit akademik, përmes koordinatorit të departamentit informon studentët për modalitetet e përmblyes së

	<p>syllabusit pjesë e të cilit është, dhe gjithashtu për mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të dijeve në programin e studimit. <b>(Rregullore e programit të studimit_MSH në Infermieri dhe Obsetrike, Detyrat e koordinatorit ).</b></p> <p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Modalitet përkatëse, si plani i diplomimit që nga momenti i aplikimit, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës të Departamentit, e deri në dorëzimin dhe mbrojtjen janë të dokumentuara. <b>(Evidenca nr.47 dhe 48 Rregullore e temës dhe modulet)</b></p> <p>Institucioni zhvillon OPEN DAYS ku aspirantët për studentë në këtë institucion mund ta vizitojnë nga afër , të marrin pjesë në procesin mesimor të njihen me ambientet etj. (Evidencë nr.67. Politikat e promovimit të programit të studimit, mënyrat e kryerjes së tij.)</p> <p>Institucioni deklaron se organizimi I ditëve të hapura ka qënë shumë I efektshëm në informin e studentëve aspirantë duke u mudësuar atyre kuptim më të mirë të ofertës universitare.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>	<b>Përmbyshet pjesërisht</b>	<b>Përimbyshet kryesisht</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Studentët e programit të studimit në lidhje me strukturë, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit , informohen përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zyrës së Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës së Pranimeve.</li> <li>• Kontakteve me stafin akademik,</li> <li>• Rregullores mësimore të programit të studimit <b>(takimi me studentët).</b></li> <li>• Diseminimit të informacionit përmes pasqyrimit fizik në vende të dukshme të orarit, kalendarit të provimeve apo njoftimeve të ndryshme.</li> <li>• Diseminimit të informacion përmes faqes së internetit të Fakultetit.</li> <li>• Kontakteve me të rregullta me koordinatorin e programit.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndet/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,	

logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Përmes koordinatorit të programit dhe Sekretarisë Mësimore studentët informohen në lidhje me programin e studimit dhe planin mësimor të cilët përmbajnë informacionin për kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite <b>[programi], [plani mësimor]</b> .
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	UKZKM ve në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëve/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, informacione të cilat janë gjithmonë të përditësiara. Këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatorja e departamentit i cili gjithashtu është në dispozicion edhe takimeve personale me studentet për zgjidhjen e çdo nevoje të tyre.
<b>Kriteri 6.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	<p>Menaxhimi i të dhënave në lidhje në tërë aktivitetin mësimor të studentëve menaxhohet nga sistemi kompjuterik UniMS në të cilën përfshihen Portali i Studentit dhe Stafit.ëëë.unizkm.al ;unims.unizkm.edu.al.</p> <p>Të dhënat e studenteve ndodhen që në momentin e regjistrimit ndodhen si në format hard copy dhe gjithashtu të dixhitalizuara ku ato bashkëngjiten.( Takim me Sekretarinë Mësimore).</p> <p>Sistemi kompjuterik ofron mundësinë e menaxhimit dhe të përpunimit të dhënave statistikore në lidhje me aktivitetin mësimor të studenteve statusin e tyre akademik dhe gjithashtu progresin dhe suksesin e tyre në kohë reale.</p> <p>Rregjistri i rezultateve të studentëve ndodhen në sekretari në formë hard copy dhe gjithashtu dhe elektronike ( evidence 68. Rregjistri i notave). Konform legjilacionit në fuqi. Koha e ruajtjes së rregjistrimit të notave se bashku me procesverbalet e provimeve është e pacaktuar.</p> <p><i>Shumica e studenteve të këtij program studimi ishin në marrëdhënie pune në institucione të ndryshme shëndetësore Shqipëtare dhe Italiane.</i></p> <p>Mbi mundësitë e punësimit të tyre, institucioni i orienton përmes Zyrës së Këshillimit të Karrierës e cila mundëson krijimin e marrëveshjeve me instucione dhe subjektë të ndryshme, dërgimit të njoftimeve në lidhje me mundësitë e punësimit, llojet e kontrave të punës, gjithashtu Zyra e karrierës bën orientime dhe ofron mbështetje edhe në lidhje me mënyrën e orgazmit dhe sjelljes gjatë intervistave të punësimit, mënyrën e përpilimit të CV-ve etj. <b>(takim me përfaqësues të Zyrës. Takimi me studentët)</b></p> <p><i>Gjatë takimit me student GVJ vuri re entuziazëm, synime të qarta për karrierën e tyre dhe arsye konkrete për zgjedhjen dhe ndjekjen e këtij</i></p>

	<i>program studimi.</i>			
	Zyra e Këshillimit të Karrierës ndjek karrierën e studenteve edhe pas diplomimit të tyre, duke marrë informacione të vlefshme dhe impakte nga zhvillimi i tyre si profesional ashtu edhe akademik.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon të dhëna në lidhje me numrin e studenteve të regjistruar dhe diplomuar në programin e studimit, ky proces realizohet nga Zyra e Statistikave e cila krijon një bazë të plotë të dhënash. Të dhënat të cilat gjenerohen nga kjo zyrë përdoren jo vetëm nga Njësia e Brendshme e Vlerësimit të Cilësisë por dërgohen edhe në institucionet shtetërore si Ministria e Arsimit dhe Agjensia e Sigurimit të cilësisë. [vizita në AL].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon të dhëna në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për secilin program studimi. Në programin e MSH në Infermieri dhe Obstetrike GVJ evidenton se deri më tani duke filluar nga viti akademik 2015-2016 janë çregjistruar 4 (katër) studente, kryesisht për çështje dokumentacioni.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Zyra e Statistika në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimorë këto të dhëna i përdor jo vetëm për peëplimin e raporteve por gjithashtu për analizimin e efikasiteti cilesor dhe sasior.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për personat e autorizuar të dhënat janë të verifikueshme dhe të aksesueshme përmes aplikacionit UniMS ku statistikën vendosen në kohë reale, ky sistem mundëson ruajtjen, menaxhimin dhe aksesin e të dhënave për personat e autorizuar.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Të dhënat kanë të bëjnë me planin e studimit, modulet, provimet, kalueshmërinë, frekuentimin, statusin e studentit, statistikën në lidhje me pyetsoret etj. Te gjitha të dhënat në lidhje me statusin dhe veprimtarinë e studentit



	<p>dhe të pedagogëvesigurohen në mënyrë vullnetare duke ruajtur privatësinë e tyre.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre. (Verifikuar gjatë vizitës në IAL)</p> <p><i>Nga verifikimi i dokumentacionit në letër (hard -copy), GVJ nuk identifikoi ndonjë pasakatësi që lidhen me mungesa në dokumentacion, mungesë të numrit të matrikullimit apo pasaktësi në plotësimin e regjistrimit themeltar.</i></p> <p>Institucioni arkivon rregullisht të gjitha rezultatet e të nxenit. si në hard copy ashtu dhe në forme elektronike. Listat e notave dhe Procesverbalet e provimeve ruhen për një kohë të pacaktuar në sekretarinë mësimore ( Verifikim dokumentacioni nga GVJ)</p> <p>Në programin MSH në Infermieri, janë të regjistruar për vitin akademik :</p> <p><b>2015-2016 -11 student;</b></p> <p><b>2016-2017 – 10 student;</b></p> <p><b>2017-2018 – 8 student;</b></p> <p><b>2018-2019 - 8 student;</b></p> <p><b>2019-2020 - 4 student;</b></p> <p><b>2020-2021 - 18 student;</b></p> <p><b>(Evidenca nr.9. Tëdhënat e studentëve për v.a 2015-2021)</b></p> <p><i>GVJ rekomandon përpilimin e raportit analitik për këta studentë me qëllim evidentimin e problemeve në cilësinë e daljes, punësimin dhe marrjen e masave të duhura për përmirësimin e treguesve.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e	Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit ( <b>statuti, rregullorja e përgjithshme, etj</b> ), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të UKZKM. Zgjedhja e studentëve në strukturat

<p>këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>vendimmarrëse behte përmes një procesi zgjedhor të bazuar në nenin 99 lidhjet 80/2015 “Për Arsmin e Lartë dhe kërkimin Shkencor” dhe Statutit të IAL ( Evidence nr. 12).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Strukturat kryesore në të cilat ka pjesëmarrje të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli Kombëtar Studentëve-realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.</li> <li>- Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.</li> <li>- NJSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjeshme të mëparshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore por gjithashtu mundësohet edhe përmes zhvillimit të, pyetësoreve on line në lidhje me vlerësimin e procesit mësimor, shqyrtimit dhe plotësimit të kërkesave të studentëve. Drejtuesit e Departamentit , Fakultetit dhe koordinatori i programit mund të marrin pjesën e mbledhjet e Këshillit Studentor me qelime adresim dhe zgjidhjen e problematikave.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Të gjitha të dhënat mblidhen dhe adresohen për zgjidhje dhe përmirësim. <b>(takimi me studentët).</b> Një student i programit MSH në infermieri është dhe pjesë e GVB e cili ka hartuar RVB.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p><i>Programi i studimit MSH në Infermieri dhe Obsetrike është një program i përbashkët me Universitetin Tor Vergata në Rome Itali, ai nuk i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve që nga momenti i akreditimit të parë , institucioni deklaron se ndryshimet e programit mund të xiten prej tyre ,por aprovohen vetem nga Institucioni partner i Arsimit të Lartë, në këto kushte mungon kompetenca dhe mundësia për ndryshimin e programit.</i></p> <p>Instucioni deklaron që është i hapur në përfshirjen e studenteve në proceset e rishikimit dhe përmirësimin të programit dhe i mirëpret cdo sugjerim , por GVJ ve re se mundësia e studenteve për të luajtur një rol real në këtë proces nuk ekziston, kjo për arsye të lëshimit të një diplome të dyfishtë me një Univesitet partner.</p> <p><i>GVJ propozon që gjatë fazës së rishikimit të kurrikulës, të përfshihen studentë dhe ku është e mundur të reflektohen sugjerimet dhe propozimet e tyre.</i></p> <p>Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve realizohet sipas një procesi transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të institucionit. Provimet realizohen të sekretuara dhe pedagogu organizon seanca sqaruese me qëllim argumentimin e vlerësimit.</p> <p>Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentat rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik,</p>

	<p>administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit, të komentojnë rezultatin dhe të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvehtësojnë sa më shumë dije. <b>(Takimi me stafin, Takimi me studentët).</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivoi pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Bazuar në dokumentacion GVJ evidenton se personeli akademik është aktiv duke marrë pjesë në konferenca dhe kongrese ndërkombëtare, me prezantim oral apo postera. <b>(Cv e stafit akademik).</b> Gjithashtu gjatë vizitë në institucion dhe në RVB , GVJ evidenton se UNIZKM nxit angazhimin e personelit akademik në projekte kërkimore shkencore, konferenca , publikime duke marrë edhe mbështetje financiare nga institucioni .</p> <p>Institucioni ka politika konkrete në lidhje me mbështetjen financiare të kërkimit shkencor dhe ka ngritur Komision e Strategjive të Kërkimit Shkencor i cili përcakton strategjitë, shqyrton kërkesat për mbështetje financiare që vijnë nga njësitë bazë, vlerëson dhe monitoron projektet shkencore. <b>( Evidence nr 27)</b></p> <p>Universiteti gjithashtu boton Revisten Shkencore Zonja e Këshillit të Mirë ku botimet shkencore të stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë kanë hapësirë të dedikuar.</p> <p>Programi Master Shkencor në Infermieri dhe Obsetrike ofrohet si një program i përbashkëm me Universiteti Tor Vergata të Romës dhe si i tillë ofrohet në kuadrin ligjor Italian duke krijuar mundësinë edhe të studimeve, aktiviteve shkencore si konferenca, seminare, simpoziume dhe gjithashtu projekteve të përbashkëta.</p> <p><i>GVJ nuk gjeti të dhëna për bashkëpunime me Institucione të tjera të huaja të arsimit të lartë.</i></p> <p>Gjatë takimit me përfaqësues së zyrës së projekteve, GVJ evidentoi se IAL nuk ka projekte të përbashkëta shkencore me institucione të tjera te</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik motivoi studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

huaja në fushën e shëndetësisë, por ka disa projekte fituese me fonde të brendshme të IAL. Projekti Self Care është një nga keto projekte i cili i përket fushës së kujdesit infermieror.

***GVJ vlerëson ofrimin e programit Master në Infermieri dhe Obsetrike si një një program të përbashkët me një universitet European, por gjithashtu sugjeron rritjen e numrit të marrëveshjeve dhe me institucione të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim rritjen e shkëmbimit shkencor dhe përvojave të mesimdhënies. Këto bashkëpunime do të rrisnin akoma më shumë kompetencat që fiton studenti në fund të studimeve.***

Stafi akademik motivon studentët dhe i fton të marrin pjesë në aktivitete shkencore që zhvillon Universiteti, por nuk ka evidencë për publikime apo botime të studentëve të këtij programi, në revista apo buletine shkencore.

***Sugjerojmë që, një mundësi për të motivuar studentët do të ishte bashkëpunimi dhe publikimi i studimeve apo punimeve të përbashkëta pedagog – student.***

Institucioni akordon çdo vit një fond të vecantë në buxhet për stafin dhe studentët si mbështetje financiare për publikimin e punimeve kërkimore – shkencore në revista shkencore jashtë vendit.

Edhe pse programi Master i Shkencave në “Infermieri”, si një program i aplikuar në shkencat mjekësore, synon të angazhojë stafin akademik dhe studentët në rrugën e kërkimit shkencor, nuk ka mundur të përfshihet në studime inovative apo të hapë rrugë drejt patentave.

Në funksion të realizimit të diplomës, çdo studenti i ofrohet asistencë në modelimin e punimit, mbledhje dhe perpunimit të të dhënave, realizimit të analizave etj. Mqs Institucioni është i paisur me laboratore mesimorë dhe ka marrvshje me Institucione Shëndetësore, ***GVJ sugjeron stafin, të shfrytëzojë akoma më mirë kapacitetet institucionale për realizimin e temave të diplomës nga ana e studentëve, veçanërisht në orientimin infermieror të kërkimit shkencor.***

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet			
	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat	UKZKM ka një politikë të qartë bashkëpunimi me organizmat

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	shkencorë kombëtarë e ndërkombëtarë me qëllim mobilitetin e stafit akademik dhe studenteve.
<b>Kriteri 2.</b> Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Një rol specifik në këtë proces luan Zyra e e Projekteve Kërkimore dhe Formuese ecila informo studentët dhe stafin akademik mbi të gjitha mundësitë e mobiliteteve, për qëllime studimore, praktika, mësimdhënie, trajnime etj. <b>(Ditët informuese të Erasmus web. Faqja zyrtare ).</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	Stafi akademik nxitet dhe merr pjesë në aktivitete informuese të organizuara nga instucione kombetare si Zyra Erasmus, Delegacioni i BE –së në Shqipëri , Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Materialet shpërndahen gjatë ditëve të informimit të organizara nga IAL. <b>(Pjesmarrje në E+; Publikimi i shpalljeve të mobilitetit. Faqja zyrtare web)</b>
<b>Kriteri 4.</b> Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	GVJ evidenton se për sa i përket programit të studimit MSH në Infemieri procesi mësimor realizohet si nga staf akademik i universiteti partner ashtu dhe staf akademik shqiptar. Në lidhje me stafin akademik shqiptar GVJ evidentoi se nuk ka mobilitet në universitetet partnere, dhe gjithashtu as mobilitet të studentëve. Theksojmë se studentët të cilët ndjekin këtë program studimi janë Shqiptarë dhe Italianë.
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	<i>Në takimin me studentet GVJ evidentoi që interesi i studenteve të këtij programi për mobilitet është i pakët, panvarsisht mundësive që mund të ofrojë institucioni, në vlerësojmë se kjo lidhet me faktin se shumica e studenteve janë në marrëdhënie pune dhe objektiv kryesor i tyre është rritja profesionale dhe në pozicione administrative e menaxheriale.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	Stafi akademik është i motivuar të implementojë metoda të kërkimit shkencor, implementim i cili mbështetet edhe në kurrikulën e këtij programi me qëllim që studentët të kenë përgatjen e duhur për vazhdimin e metejshtëm të studimeve, sic është evidentuar më lart në raport ky është një program kryesisht me drejtim administrativ dhe kërkimor shkencor, një pjesë e lëndëve kurrikulare janë të lidhura me metodologjinë e kërkimit shkencor, përpunimit të rezultateve etj.  Megjithatë në takimin me studentët, pyetjes se kush do të vazhdonte studimet në ciklin e tretë nëse i jepej mundësia, iu përgjigjën pozitivisht pak studentë, c'ka tregon një <i>motivim të dobët të studentëve për vazhdimësinë e studimeve doktorale, aspirat kryesore të studenteve të këtij programi si atyre Italianë dhe shqiptarë ishin kryesisht në zhvillimin e karrierës së tyre në drejtim administrativ dhe menaxherial. (Takimi me studentët).</i>  Institucioni mirëpret studiues të jashtëm apo pjesëtarë të stafit akademik dhe mbështet projektet ambicioze që vlerësohen pozitivisht

	<p>Zyra e Projekteve Kërkimore dhe Formuese asiston programin ERASMUS + dhe marrëveshjet me IAL partnere, në bazë të propozimeve konkrete nga Fakultet apo departamentet përgatit projekt propozimet, ofron informacion dhe menaxhan aplikimet për mobilitet si të studenteve dhe te stafit akademik.</p> <p>Sic u theksua dhe me lart , GVJ evidentoi se IAL nuk ka projekte të përbashkta shkencore me institucione të tjera te huaja në fushën e shëndetësisë të cilat terheqin fonde të BE, por ka disa projekte fituese me fonde të brendshme të IAL. Projekti Self Care është një nga keto projekte i cili i përket fushës së kujdesit infermior.</p> <p>IAL merr pjesë si partner në aktivitete të kërkimit shkencor dhe është i hapur për të përdorur infrastrukturën dhe labororet për kërkime. <i>Por, nuk ka evidencë për të dëshmuar thithjen e kërkuesve të huaj apo vendas, pavarësisht vullnetit të mirë. Gjithashtu nuk ka eksperiencë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore, vendas apo të huaj.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, Zyra e Pranimit të Studentëve ofron e para të gjithë informacionin për të gjithë studentët aspirantë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit dhe procedurat e aplikimit , konkurimit dhe pranimit në IAL. Zyra gjithashtu jep informacione të detajuara dhe asiston gjatë procesit studentëve të cilët janë të diplomuar jashtëShqipërisë. Zyra ofron shërbim jo vetëm përmes kontaktit të drejtpërdrejtë por me ana mjeteve dixhitale, ëeb, email, mediave sociale faqes zyrtare të Institucionit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar	Gjatëtërë periudhës së studimeve studenti asistohet nga Sekretaria Mësimore.Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar

informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

**Kriteri 4.** Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse

konsulencën përkatëse për çështje akademike dhe studentore progresin e studentit, procedurat e diplomimit etj.

Gjithashtu institucioni me anë të këtyre organizmave bën këshillim për përzgjedhjen e programeve të studimit, si edhe orientim për përfshirjen në tregun e punës

Informimi, këshillimi, ndjekja e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatori i programit. Informacioni dhe orientimi e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionale realizohet kryesisht në nivel departamente nga koordinatorja e programit.

Zyra e Pranimit të Studentit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës, ndjekecurinë e studimeve të studentit, që ngamomenti i regjistrimit, derinë diplomimin e tij. Këto njësi së bashku me koordinatorin e programit ofrojnë asistencë të vazhdueshme dhe orientojnë studentet në lidhje me të gjitha etapat akademike, zgjedhjen e praktikës profesionale në institucione të tjera dhe gjithashtu orientimin në tregun e punës.

Zyra e Këshillimit të Karrierës e asiston dhe mbështet studentin gjatë tërë periudhës së kërkimit të punës, duke i trajnuar për zhvillimin e intervistave dhe në përgatitjen e dokumentacionit apo të CV-së.

Zyra mban kontakte të vazhdueshme edhe pas diplomimit të studentëve me qëllim vlerësimin real të outputit akademik dhe rritjes profesionale, GVJ evidentoi se të gjithë studentët e diplomuar në këtë program studimi janë të punësuar.

Gjatë takimit me studentin u deklarua se personeli akademik luan një rol të rëndësishëm si në këshillim akademik ashtu edhe këshillim karriere.

Gjatë takimi me përfaqësuesit e zyrës u theksua se institucioni ka ngritur dhe ka funksional rrjetin ALUMNI i cili ka një data bazë të plotë, Zyra kontakton në mënyrë të përvitëshme anëtarët dhe përditëson ndryshimet në karrierën e tyre. Të dhënat janë në dispozicion të personave të autorizuar sic janë organet drejtuese apo studentët e programit. ( Takimi me përfaqësues të zyrës).

Anëtarët Alumni kanë komunikim të vazhdueshëm kryesisht përmes grupeve të dedikuara në rrjetet sociale.

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## V. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNIZKM ka përpunuar , zbaton politika dhe ka ndërtuar stuktura dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë: “Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë”. Struktura dhe funksionimi i Komisionit së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjgjëgjësistë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, të programeve të studimit, aspekteve te mësimdhënies etj. Politikat e vlerësimit të cilësisë nëUKZKM kanë filluar të zbatohen që në vitin e parë akademik 2004-2005 , ku institucioni ka përdorur të njëjtat mekamina të përdorura në unversitet partnere italiznaë. Këto politika përcaktohen në Statutin e IAL, rregulloren e UKZKM , Rregulloren e mbi Njësinë e Vlerësimit të Cilësisë ( <b>evidencë nr. 71</b> ) këto politika janë në përputhje më parashikimet ligjore e nënligjore.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. IAL, bazuar në Statut, në Rregulloren e Vlerësimit të cilësisë dhe me vendim të Senatit Akademik është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. Kjo njësi funksion në bashkëpunim të ngushtë mëZyrën e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave. ( Evidencë nr.77)
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të	



SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit

Njësia ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj dhe vlerëson në mënyrë periodike aktivitetin mësimor dhe kërkimor shkencor të institucionit.

Në përbërje të NJSBC janë **4 persona personel akademik**, ku përfshihen përfaqësues të Fakulteteve dhe **një ekspert i jashtëm**, gjithashtu në përbërje të NJSBC janë dhe **një përfaqësues të studentëve (Evidencë .Nr. 80, Tabela përmbledhëse I Aneks), mandati i anëtarëve ka një kohëzgjatje 5-vjecare.**

Në detyrat e NJSBC përfshihet vlerësimi i rezultateve të veprimtarive mesimore, kërkimore shkencore duke propozuar dhe ndryshime të nevojshme në funksion përmirësimin evazhdueshëm të cilësisë. **(Rregullore NJSBC ,takim me përfaqësues të zyrës. )**

Përveç kësaj stukture institucioni ka ngritur Zyrën e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave e cila përpunon politikat dhe strategjitë në funksion të rritjes së cilësisë.

Institucioni ka dhe përdor instrumenta për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. UKZKM i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional gjithashtu dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të Universitetit dhe harton Raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm të cilat diskutohen në të gjithë njësitet e IAL .

Mënyra kryesore e vlerësimit realizohet më anë të pyetësorëve të studentëve në lidhje me mësimdhënien dhe stafin akademik. Për përpunim e pyetësorëve janë marrë shume modele të universiteteve Italia dhe përshtatur edhe në varësi të specifikave të Institucionit , Programit të studimit dhe profilit të studentëve. **(Evidenca 411;41.2)**

Gjithashtu Njësia së bashku me Koordinatorin e programit organizon takime të përmuajshme me studentët e programit gjatë cilat mendimi, problematikat dhe vlerësimi i tyre merret në kohë reale.

Ajo e bazon veprimtarinë e saj në dokumenta konkrete dhe përpilon një plan kalendarik veprimi, për realizuar planin e saj ajo bashkëpunon ngushtësisht më të gjitha strukturat akademike dhe administrative të institucionit dhe ka akses në gjithë dokumentacion akademik dhe administrativ, duke ruajtur anonimatën dhe konfidencialitetin.

Kjo njësi periodikisht informon drejtuesit e njësive, në lidhje me rezultatet e monitorimeve më qëllim rëfleksimin dhe përmirësimin e problematikave.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve. Njësia përgjegjëse për kryerjen e këtij funksioni është Zyra e Vlerësimit të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe njëkohësisht Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me njëra tjetrën.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.	Njëkohësisht në përmbushjen e këtyre qëllimeve një rol të rëndësishëm kanë departamentet ku koordinatorët e programeve realizojnë funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	NJSBC ka realizuar një analizë vjetore të këtij programi studimi të përfshirë në raportin e përgjithshëm të IAL-së, ku janë përfshirë informacione në lidhje me vlerësimin e studentëve për personelin e angazhuar në program, perceptim e tyre në lidhje me aspektet e mësimdhënies, aspektet administrative, këshillimit të karrierës, asistencës institucionale etj.
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<i><b>GVJ nuk ka evidentuar procese konkrete të dokumentuara të rishqyrtimit rishikimit më qëllim përmirësimin në këtë program studimi.</b></i>
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe gjatë takimeve me Stafin GVJ evidenton se programi nuk ka pësuar ndryshme kurrikulare që nga momenti i hapjes së tij, kjo lidhet me faktin se ky është një program i përbashkët me një universitet partner i konceptuar në bazë të Legjislacionit Italian dhe ndryshimet e kurrikulës mund të realizohet vetëm nga Universiteti partner panvarësht sygjërimeve të cilat mund jepen nga UKZKM.  UKZKM përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herëshme të programit të studimit. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të

	<p>ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përbushjes së standarteve akademike.</p> <p>IAL përdor metodologji vlerësimi, instrumentat matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbajtjen e programit të studimit si pyetësorin e studentëve. <b>(Ref 40, 40.1, 41. Pyetësorët e Studentëve) apo dhe takimet e përmuajshme të koordinatorës me studentet e programit.</b></p> <p>Rezultatet e aktiviteteve me karakter vlerësues dhe monitorues dokumentohen dhe raportohen pranë rektoratit dhe njërive kryesore, njëkohësisht KSBC adreson mangësi dhe rekomandon detyra me qëllim përmirësimin e cilësisë.</p> <p><i>GVJ rekomandon rritje e efikasitetit në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani punë me adresim konkret të problematikave.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Bazuar në dokumentet e UKZKM dhe nga informacioni i marrë, rezultojnë se NJSBC bën vlerësim institucional dhe harton raporte për të gjithë programet e studimit, për këtë arsye, GVJ nuk evidentoi raporte periodike të vlerësimit të këtij program studimi, <b>GVJ thekson se analiza vjetore e programit e përfshirë në raportin e përgjithshëm ka të dhëna sasiore por nuk bën analizë apo adresim të problematikave.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Për kryerjen e vlerësimit NJSBC përdor metoda dhe instrumente të ndryshme për mbledhjen informacionit sic janë: intervistat e strukturuar, intervistat joformale, takimet e drejtpërdrejta me studentet e programit. Gjithashtu institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta sic janë:
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të	Monitorimin i mësimdhënies, <b>vlerësim të cilësisë së mësimdhënies</b> , vlerësimi i kurrikulës, monitorimi i provimeve, dëgjime në auditor, vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve, praktikës etj, <b>[takimi me stafin, drejtuesit]</b> . Institucioni, gjithashtu përdor dhe instrumenta të tërthorta vlerësimi

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

<p>provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>sic janë ; sondazhe të studentëve , të personelit akademik, ndihmës akademik apo të institucioneve të cilat bashkëpunojnë për programin e studimit , intervista etj. Rezultatet e këtyre vlerësimeve raportohen tek drejtuesit e departamente dhe dekanëve, duke u bërë pjesë e vlerësimit të performancës të cdo pedagogu në fund të vitit akademik.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program</p>	<p>Të dhënat e drejtpëdrejta apo të tërthorta që tërheq dhe përpunon NJSBC shërbejnë për të evidentuar treguesit problemikë të cilësisë me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e tyre.</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon takime të rregullta të përvitëshme me Alumni , këto takime janë shumë të vlefshme për të tërhequr mendimet e studenteve të diplomuar, sa ka ndikur arsimi i marrë nëIAL për karrierën e tyre , cfarë gjërat mund të përmirësohen me qëllim rritje e komptencave profesionale për të përballuar sa më mirë tregun e sfidat e profesionit.</p> <p>Theksojmë që aktorët e jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale por <i>mungon kontributi i tyre konkret në vlerësimin e realizimit dhe cilësisë së programit të studimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së tij.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Komisioni përbëhet nga Kryetari i Komisionit, <b>4 persona personel akademik</b>, ku përfshihen dhe <b>një ekspert i jashtëm</b>, gjithashtu në përberje të NJSBC janë dhe <b>një përfaqësues të studentëve</b>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë</p>	<p>Duke u bazuar në ligjislacionin në fuqi, Rregulloren e NJSBC, Institucioni ka përcaktuar detyra konkrete dhe të ndryshme për të gjithë Anëtarët përbërës të Njësisë të Sigurimit të Cilësisë, „me qëllim garantimin e cilësisë së programeve të studimit. <i>GVJ evidentoi të anëtarët e NJSBC entuziazëm dhe përgjegjshëri të</i></p>


<p>dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p><i>lartë profesionale.</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e NJCBC.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm, sic janë studentet, stafi administrativ stafi akademik, në proceset e vlerësimit realizohet në tërë hapat e procesit ; që nga mbledhja e të dhënave, rregjistrimi , përpunimi, analizimi, realizimi i intervistave formale dhe jo formale, takimeve me studentët deri në nxerjen e përfundimeve me qëllim përmirësimin e indikatorëve të cilësisë.</p>			
<p><b>Shtylla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk është përmbushur</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

I gjithë ky proces përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve , duke respektuar integritetin akademik dhe shmangjen e diskriminimit apo pabarazisë.

UNIZKM ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit.

*Mendojmë që angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj duhet të rritet dhe të ketë efekte konkrete në përmirësimin e tij.*

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente</p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p> <p>Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore</p>




dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Ndërkohë informacionet në lidhje me veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për institucionin në tërësi janë të pakta <b>[faqja e internetit UNIZKM)</b> .			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<b>Në RVB deklarohet se raportet NJSBC bëhen publike për studentët, pedagogët dhe administratën, por GVJ nuk evidenton dhe nuk mund të verifikojë këtë proces.</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale. Në RVB deklarohet se në të dhënat në raportet e vlerësimit ruajnë privatësinë dhe etikën akademike. <b>(Verifikuar nga GVJ. Evidenca 42. Perceptimi i Studentëve për veprimtarinë mësimore).</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	GVJ theksoi më lart se në raportimet që janë kryer nga IAL janë raporte përshkruese jo analitike. Këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.  <i>Prandaj GVJ rithekson që në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni duhet të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm</i>  GVJ vlerëson se stafi akademik dhe studentët janë të përfshirë në sigurimin e brendshëm të cilësisë kryesisht në metodat e tërthorta të përdorura nga NJSBC, pjesëmarrjes së studentëve në struktura institucionale , por GVJ rekomandon shtimin dhe rritjen e efijencës se aktiviteteve me personelin dhe studentët ,me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkencat Infermieristike dhe Obstetrike" të Institucionit të Arsimit të Lartë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".**

**Pika të forta dhe afirmime**



1. Pajisja e studentëve me një diplomë të përbashkët të BE-së, krijon mundësi të mira si në punësim ashtu edhe në kualifikime të mëtejshme. Kurrikula e programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në "Shkenca Infermieristike dhe Obsetrike" është hartuar bazuar në modelin e Universitetit Tor Vergata në Itali duke respektuar standardet dhe kornizën ligjore shqiptare në fuqi.
2. Mësimdhënie nga një staf akademik i përbashkët me Universitetin "Tor Vergata" krijon më shumë mundësi për shkëmbim eksperience me qëllim rritjen e cilësisë dhe aplikimin e metodave europiane në mësimdhënie.
3. Në funksion të programit të studimit është një infrastruktura laboratorike bashkëkohore dhe me paisjet e nevojshme didaktike, informatike etj.
4. Përfshirja e pedagogëve dhe studentëve në punë kërkimore shkencore e projekte si dhe mbështetja financiare nga UKZKM për projekte të pedagogëve.
5. Biblioteka me një literaturë të pasur dhe përditësuar, e organizuar dhe skeduar në mënyre profesionale, me infrastrukturë të nevojshme në funksion të studenteve dhe stafit akademik.
6. GVJ evidentoi se të gjithë studentët e diplomuar në këtë program studimi janë të punësuar.

**Pika të dobta**

1. Shpërndarja jo uniforme e ngarkesës përgjatë vitit akademik që mund të ketë ndikim në vijueshmërinë e përgatitjes së studentëve dhe në shkallën e asimilimit të dijeve.
2. Në kuadër të përmirësimit të treguesve të cilësisë, institucioni nuk zhvillon më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

**Rekomandime**

1. GVJ rekomandon shpërndarje uniforme të ngarkesës mësimore të shprehur në ECTS përgjatë vitit akademik. GVJ mirëkupton faktin që dhënia e një e diplome të dyfishtë kufizon organizimin e procesit akademik, por GVJ rekomandon shtrirjen e programit gjatë tërë periudhës semestrale dhe gjithashtu rritjen e ngarkesës mësimore, e cila mbulohet nga pedagogë të cilët jetojnë në Shqipëri.
2. GVJ rekomandon titullarët e lëndëve të jenë të gjithë të kategorisë Profesor.
3. GVJ vlerëson ofrimin e programit Master në Infermieri dhe Obsetrike si një program të përbashkët me një universitet Europian, por gjithashtu sugjeron rritjen e numrit të marrëveshjeve dhe me institucione të tjera si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim rritjen e shkëmbimin shkencor dhe përvojave të mesimdhënies. Këto



- bashkëpunime do të rrisnin akoma më shumë kompetecat që fiton studenti në fund të studimeve.
4. GVJ sugjeron stafin, të shfrytëzojë akoma më mirë kapacitetet institucionale për realizimin e temave të diplomës nga ana e studentëve, veçanërisht në orientimin infermieror të kërkimit shkencor.
  5. GVJ rekomandon shtimin e aktiviteve shkencore si konferenca, simposiume dhe gjithashtu rritjen e pjesëmarrjeve në projekte të BE të dedikuara në fushën e mjekësisë në përgjithësi dhe atë të infermieristikës në veçanti.

## **Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Nursing and Obstetric Sciences" of the Higher Education Institution of the Catholic University "Lady of Good Counsel"**

### **Strengths and affirmations**

1. Equipping students with a common EU diploma creates good opportunities in both employment and further qualifications. The curriculum of the study program of the second cycle Master of Science in "Nursing and Obstetric Sciences" is designed based on the model of "Tor Vergata" University in Italy, respecting the standards and the Albanian legal framework in force.
2. Teaching by a joint academic staff with the University "Tor Vergata" creates more opportunities for exchange of experience in order to increase the quality and application of European methods in teaching.
3. In function of the study program is a modern laboratory infrastructure with the necessary didactic equipment, informatics, etc.
4. Involvement of professors and students in scientific research work and projects as well as financial support from UKZKM for professors' projects.
5. Library with a rich and updated literature, organized and filed in a professional way, with the necessary infrastructure for the function of students and academic staff.
6. EEG noted that all graduate students in this study program are employed.

### **Weaknesses**

1. Non-uniform distribution of teaching load throughout the academic year which may have an impact on the continuity of student preparation and the degree of knowledge assimilation.
2. In the context of improving quality indicators, the institution does not further develop analytical mechanisms for identifying performance at the institutional level and addressing issues in the context of continuous improvement.

### **Recommendations**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



1. EEG recommends uniform distribution of teaching load expressed in ECTS throughout the academic year. GVJ understands the fact that awarding a double degree limits the organization of the academic process, but EEG recommends extending the program throughout the semester period and also increasing the teaching load, which is covered by professors living in Albania.
2. EEG recommends that the course holders be all of the Professor category.
3. EEG evaluates the provision of the Master program in Nursing and Obstetrics as a program joint with a European university, but also suggests increasing the number of agreements and with other institutions both inside and outside the country, in order to increase scientific exchange and teaching experiences. THESE collaborations would further enhance the competencies the student gains in end of studies.
4. EEG suggests the staff to make even better use of the institutional capacities for the realization of the diploma topics by the students, especially in the nursing orientation of the scientific research.
5. EEG recommends the increase of scientific activities such as conferences, symposia and also the increase of participants in EU projects dedicated to the field of medicine in general and that of nursing in particular.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>